

NDRYSHIMET E PROPOZUARA NE BUXHETIN E RI

RRITEN PENSIONET, JA KATEGORITE QE MARRIN SHTESE 4%

Llogaritja e shtesës që pritet të merret. Rritet dhe pensioni minimal si dhe përfitimi nga kompensimet

► F 11



Nesip Ibrahim: SEKRETET

E DREJTIMIT TE TIRANES NE VITET '70-'80

Ish-kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Tiranës flet për përplasjet me Mehmet Shehun. Këshilla për Veliajn

► F 16-17

[SHQIPTARJA.com]

ÇMIMI 30 LEKË | VITI V - NR. 267 | E MËRKURË, 11-11-2015 | www.shqiptarja.com

LIDHJA E SHKRIMTAREVE DOSJA E SIGURIMIT PER INTRIGAT DHE THASHETHEMET



Spiuni: Sandër Banushi, Lllazar Siliqi dhe Ndrek Luca më thanë se Fadil Paçrami lufton katolikët shkodranë dhe mbron myslimanët. Gara mes Fatos Arapit dhe Ismail Kadaresë. Ja si funksiononin klanet mes shkrimtarëve dhe ç'flisnin pas krahëve të njëri-tjetrit

► FAQE 18-19

Në foto mjetas: Fatos Arapit, djathtas; Ismail Kadare



Kërcënon prokuroren: Po të gjeta në rrugë do të bëjë për karrocë

► F 13



Farmacistët, ja 425 emrat që u është miratuar licenca

► F 10

FLET ROBERT ALIAJ: MJAFTOJNE MBATHJET E BUKURA DHE T'I KE VLERE

► F 24




**RAPORTI I KE
SHQIPERIA NGEÇ
TE REFORMA NE
DREJTESI DHE
ANTIKORRUPSIONI**

► F 2-3

Blog/ Periferi

NGA ALBA MALLEZI



Shqipëria nuk është një vend për Ju Moikom

► F 21



Romani i ri

HISTORIA E TREGUARNGA "VAJZAT E MJEGULLES"

Namik Dokle: Akoma s'jemi çliruar nga njerëzit e mafias që kanë zaptuar gjithçka

► F 4-5




"Puna më e madhe duhet fokusuar tek reforma në drejtësi, por Shqipëria nuk është gati të jetë vend anëtar me të drejta të plota. Ajo që ne kërkojmë është hapja e negociatave. Me hapjen e negociatave ne do të kemi mundësi ta çojmë Shqipërinë te 35 kapitujt"

KLAJDA GJOSHJA



"Ne kemi arritur të kemi një dokument rekomandimesh, i cili është shumë i balancuar, ndër të cilat reforma në drejtësi është më e rëndësishmja. Deputetët e mazhorancës dhe eurodeputetët ishin në të njëjtin dokument vlerësimi, por deputetët e opozitës nuk gjetën mbështetje nga eurodeputetët"

TAULANT BALLA



"Unë nuk jam befusuar pasi nuk prisja hapje të negociatave këtë vit. E para sepse Shqipëria nuk i ka plotësuar detyrimet, e dyta sepse nga njëra krizë në tjetër vendimet për zgjerimet e ardhshme të Europës gjithmonë e me shumë po plastelozhen nga eurokratët. Dëshoj për vitin tjetër"

MAJLINDA BREGU

Korrupsioni dhe drejtësia, njollat e progres-raportit

KE: Janë bërë reforma, por jo gjithçka për 5 prioritetet

ESIONA KONOMI
TIRANE

Korrupsioni në shërbimet publike dhe kryesisht ai i sistemit të drejtësisë mban peng prej vitesh progresin e Shqipërisë, në raportin vjetor të publikuar nga Komisioni Evropian. Edhe në raportin e publikuar dje, gjendja e gjyqësorit ishte shuplaka më e fortë për vendin tonë si kandidat për hapjen e negociatave. Në një analizë prej 80 faqesh, ku analizohen me detaje 5 prioritetet e lëna nga BE, Brukseli vlerëson se vendi ka bërë hapa përpara, por ende nuk ka përmbushur plotësisht 5 përparësitë kyçe që do t'i hapnin rrugën nisjes së bisedimeve për anëtarësim. Për secilën nga këto përparësi, raporti përçakton dhe detyrat konkrete që Shqipëria duhet të kryejë gjatë vitit të ardhshëm. Dokumenti është tejet kritik lidhur me gjendjen e sistemit të Drejtësisë, ndërsa vlerëson gjithashtu se korrupsioni mbetet i përhapur. Kjo është dhe fusha ku notat kritike janë shumë të forta. "Niveli i përgatitjes së sistemit gjyqësor shqiptar është në një fazë fillestare", vlerë-

4 POROSI PËR SISTEMIN GJYQËSOR

- Të miratojë strategjinë e reformës në gjyqësor, shoqëruar me planin e veprimit, dhe të ecë, përmes një procesi konsultimesh përfshirëse, me hartimin e drafteve dhe miratimin e masave të nevojshme institucionale, legjislative dhe procedurale, bazuar në standardet evropiane dhe praktikant e mira
- Të plotësojë vendet vakante në Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe në gjykatat administrative
- Të shtrijë sistemin e unifikuar të menaxhimit elektronik të proceseve dhe të sigurojë që ai të jetë efektiv, përfshirë dhe buxhetin e nevojshëm të mirëmbajtjes
- Të publikojë të gjitha vendimet e gjykatave me arsyetimin respektiv brenda një afati kohor të arsyeshëm

REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE, NË DUAR TË GJYKATAVE

- Të vazhdojë të dëshmojë që rekrutimi dhe shkarkimi i nëpunësve civil të jetë i bazuar në meritë dhe transparent, në mënyrë që të arrihet objektiv i një administrate publike profesionale dhe të depolitizuar
- Të ketë informacione të sakta mbi vendet e disponueshme në shërbimin publik përmes sistemit informativ të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe ta lidhë atë me sistemin e thesart
- Të përgatitet për zbatimin e Kodit të ri të procedurave administrative dhe të ecë paralelisht me rivlerësimin dhe përputhshmërinë e legjislacionit që lidhet me të"

son raporti, ndërsa shton se "disa përparime janë bërë vitin e shkuar, veçanërisht

me ngritjen e Komisionit parlamentar ad Hoc për Reformën në Drejtësi, për real-



izimin e një procesi reforme të gjerë dhe përfshirës". Në analizën e këtij sistemi, Raporti vëren se "administrata gjyqësore është e avashhtë dhe vendimet gjyqësore nuk zbatohen gjithmonë. Trajnimi profesional i gjyqtarëve është i papërshtatshëm dhe pavarësia e tyre nuk është plotësisht e siguruar. Përgjegjshmëria e gjyqtarëve dhe prokurorëve është e pamjaftueshme dhe

korrupsioni në sistemin gjyqësor është gjerësisht i përhapur. Bashkëpunimi ndër-institucional, është i varfër dhe burimet janë të pamjaftueshme". Sa i përket pavarësisë së gjyqësorit, Raporti thekson se ajo "është e sanksionuar në Kushtetutë. Megjithatë, në praktikë është e kompromentuar nga mënyra tejet politike e emërimeve të anëtarëve të Gjykatës së Lartë dhe

asaj Kushtetuese, dhe hapësira e madhe e diskrecionit që gëzon Këshilli i Lartë i Drejtësisë në emërimin, promovimin dhe transferimin e gjyqtarëve. Në parim gjyqtarët dhe prokurorët vendosin në mënyrë të pavarur për proceset e veçanta. Në praktikë, pavarësia e tyre është e kufizuar dhe ka njoftime të rregullta për drejtësi selektive dhe ndërhyrje politike në procese gjyqësore".

LIGJI

"Kuai ligjor për procedimet disiplinore ka paqartësi dhe disa procedime mund të përdoren për të ndikuar në mënyrë të papërshtatshme gjyqtarët".

KORRUPSIONI / "ZYRTARËT E LARTË NUK JANË HETUAR SERIOZISHT"

KE: Duhet hetime dhe ndëshkime në të gjitha nivelet

Hetimi

"Shqipëria të intensifikojë përpjekje për të garantuar aksesin direkt në bankat e të dhënave për prokurorët dhe policinë."



Komisioni Evropian shpreh shqetësim për nivelin e lartë të korrupsionit në vend, duke shtuar se janë të nevojshme dënime në të gjitha nivelet, teksa shprehet se zyrtarët e lartë asnjë herë nuk janë hetuar seriozisht. Sipas Raportit "një farë përparimi është realizuar vitin e shkuar, veçanërisht përmes miratimit të një strategjie dhe plani veprimi. Megjithatë korrupsioni është i përhapur dhe më shumë përpjekje nevojiten për të patur gjurmë solide

në hetimin, ndjekjen dhe dënimet në të gjitha nivelet, veçanërisht për rastet ku janë të përfshirë zyrtarë të nivelit të lartë. Pavarësia e institucioneve të përfshira në luftën kundër korrupsionit duhet të përforcohet, duke qenë se mbeten vulnerabël ndaj trysnisë politike dhe ndikimeve të tjera të papërshtatshme". Dokumenti i Komisionit evropian vëren se "një numër rastesh të profilit të lartë, përfshirë disa, ku faktet për dyshime për veprime të paligjshme nga ana e zyrtarëve të lartë, gjykatësve,

kryebashkiakëve dhe ish ministrave, ishin publikuar nga mediat, nuk u hetuan asnjëherë seriozisht". Sipas Komisionit evropian, në mënyrë që të përmbushë përparësinë kyçe lidhur me luftën kundër korrupsionit, vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet që në veçanti të dëshmojë përparim të mëtejshëm në krijimin e gjurmëve solide provash në hetimin ndjekjen dhe dënimet në të gjitha nivelet; të sigurojë ndjekjen e ecurisë së rasteve të shumta të denoncuar në prokurori nga ILDKPja,



"Përgjegjësia për mos hapjen e negociatave është e njeriut i cili edhe sot e kësaj dite zvarrit pafundësisht konsensusin për ligjin për dekriminalizimin duke u bërë efektivist për sërë mburojë e njerëzve që vetë promovoi në parlament, individë me rekorde kriminale"

LULZIM BASHA



"Shqipëria, de fakto është e vetmi vend në rajon, që nuk hap dot negociatat me BE. Ajo mjerisht është peng i një njeriu të vetëm, e Edi Ramës, i cili nuk synon integrimin, por pasurimin e tij të paligjshëm, njeriu që shkatërroi zgjedhjet e 21 qershorit në Shqipëri"

SALI BERISHA

STABILIZIM-ASOCIIMI

Opozita voton kundër rekomandimeve, Bumçi dhe Shehu braktisin



Deputetët e Partisë Demokratike, pjesë të delegacionit shqiptar në Komitetin e Stabilizim-Asociimit, PE-Shqipëri, kanë votuar dje kundër rekomandimeve të europarlamentarëve. Gjatë momentit të votimit, dy nga përfaqësuesit e opozitës, ish ministri të Jashtëm, Aldo Bumçi dhe Tritan Shehu kanë braktisur votimin e 17 rekomandimeve të Parlamentit Europian. Shkak është bërë mungesa e konsensusit për rekomandimet e opozitës, të cilat nuk janë përfshirë në dokumentin e PE. Për dy ditë me radhë, deputetët e mazhorancës dhe të opozitës kanë debatuar në Bruksel rreth zhvillimeve të fundit në Shqipëri dhe ecurisë së reformave të qeverisë "Rama". Në mbyllje të takimit, opozita ka propozuar disa amendamente si kusht për miratimin e deklaratës së përbashkët, por ato u rrëzuan. Ky ka qenë edhe momenti që ka shkaktuar krisjen mes palëve, e cila këtë herë është demonstruar në kryeqendren evropiane. Por, braktisja e opozitës nuk e pengoi Komitetin e Stabilizim-Asociimit PE-Shqipëri, që të miratonte 17 rekomandime për Shqipërinë në raportin e zgjerimit për vitin 2015. Në dokument theksohet mbështetja për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, ndërsa hapja e negociatave do të varet nga ritmi i reformave. Gjithashtu, Parlamenti Europian nënvizon rëndësinë e dialogut politik, kryerjen e reformës në drejtësi dhe procesin e dekriminalizimit.



Rama: Çelja e negociatave kalon nga reforma në drejtësi

Ambasadorja e BE, Romana Vlahutin i dorëzon progres-raportin kryeministrit dhe kryetarit të Kuvendit. Ilir Meta: Të miratojmë "dekriminalizimin"

LEONARD QUKU
TIRANË

Kryeministri Edi Rama e sheh procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian të ndërlidhur me reformën në sistemin e drejtësisë. Teksa mori në dorë dokumentin e progres-raportit për vitin 2015-ë nga ambasadorja e BE në Tiranë, Romana Vlahutin, kreu i qeverisë theksoi se krahas korpunit të reformave të domosdoshme për të përfunduar vendin me bllokun 28 anëtarësh, sfida mbetet "drejtësia", nga e cila sipas tij, varet çelja e negociatave. "Për ne është e qartë dhe ky Progres-raport e konfirmon se rruga për hapjen e negociatave kalon nëpërmjet reformës në drejtësi, e cila mbetet sot, sfida më e madhe jo vetëm e kësaj shumice qeverisëse, por e shoqërisë shqiptare dhe e shtetit tonë në rrugën drejt anëtarësimit drejt Bashkimit Europian", u shpreh Rama gjatë konferencës së përbashkët për shtyp me ambasadorën Vlahutin. Implementimi i reformës duket akoma edhe më i rëndësishëm, ndaj Rama dhe Vlahutin nënvizuan se Brukseli pret të shikojë dënime nga drejtësia shqiptare. "Realizimi i reformës në drejtësi do të çelë një fazë të re, duke krijuar kushtet për



EDI RAMA

"Ky Progres-raport e konfirmon se rruga për hapjen e negociatave kalon nëpërmjet reformës në drejtësi, e cila mbetet sot, sfida më e madhe jo vetëm e kësaj shumice qeverisëse, por e shoqërisë shqiptare dhe e shtetit tonë"



ILIR META

"Natyrshisht, që mbetet mjaft e rëndësishme për të ardhmen, sidomos për çeljen e negociatave, të ecim sa më shpejt për të mbyllur procesin e dekriminalizimit dhe për të përmbyllur reformën në drejtësi"



Romana Vlahutin dhe Edi Rama

të pasur hetime të besueshme dhe cilësore, gjykime të drejta dhe dënime të merituar në të gjitha nivelet dhe posaçërisht në nivelin e zyrtarëve të lartë",

tha Rama. Për ambasadorën e BE, përveç reformës në drejtësi si faktor kyç për negociatat, me rëndësi është edhe lufta ndaj korrupsionit. "Nëse lexoni me

kujdes listën e sfidave, sidomos ato që kanë të bëjnë me prioritetet kyçe, është e qartë se pjesa më e madhe e tyre kanë të bëjnë me shtetin e së drejtës

dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë. Rëndësi e veçantë i jepet nevojës për të pasur një vijimësi të besueshme, që do të thotë hetime, procese dhe dën-

ime ndaj kimit të organizuar dhe korrupsionit në të gjitha nivelet" - u shpreh Vlahutin. Vlahutin e përmbodhi raportin duke cilësuar të mirë. Ajo theksoi se Shqipëria ka bërë shumë, ndonëse ka akoma më tepër për të bërë. Ndërsa kryetari i Kuvendit Ilir Meta sheh si kusht të Brukselit, për avancimin e projektit evropian të Shqipërisë, edhe procesin e dekriminalizimit. "Natyrshisht, që mbetet mjaft e rëndësishme për të ardhmen, sidomos për çeljen e negociatave, të ecim sa më shpejt për të mbyllur procesin e dekriminalizimit dhe për të përmbyllur reformën në drejtësi", tha Meta, duke e cilësuar atë si mjaft të rëndësishme për të forcuar sundimin e ligjit në vend, për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", tha kryetari i Kuvendit, pas takimit me ambasadorën e Bashkimit Europian, Romana Vlahutin.

“Ju tregoj “Vajzat e mjegullës”, me personazhe pa emra”

Namik Dokle: Kam mbajtur ditar çdo ditë gjatë gjithë jetës sime politike, ndoshta i botoj

ESIONA KONOMI
TIRANE

Deputeti i Partisë Socialiste, Namik Dokle, ka zhveshur për pak kohë kostumin e politikanit për të provuar të vijë pranë lexuesve si autor i një romani. Në një intervistë për gazetën Shqiptarja.com, ai tregon për “Vajzat e Mjegullës”, si një roman i frymëzuar nga jeta e tij e fëmijërisë, dhe që përqipet të shtrihet në jetën e sotme, ku secili gjen veten nga jeta e dëshpëruar tek shpresa për një sinjal më të mirë, nga mjegulla në pritje të vajzave. Një roman me protagonistë pa emra, me të cilin Dokle guxon të rrokë lexuesit nga adoleshentët tek intelektualët. Teksa rrëfëhet për inspirimin për të botuar këtë libër bazuar mbi një ditar 20 vjeçar të xhaxhait të tij, Namik Dokle zbulon se edhe ai ka mbajtur ditar në çdo ditë të jetës së tij politike, i cili mund të botohet në të ardhmen. Deputeti Namik Dokle thotë për Shqiptarja.com se ky është mandati i tij i fundit si deputet, pasi ka vendosur që të mos kandidojë më, pasi është deputeti më i vjetër i parlamentit, përjashtuar Sali Berishën. I pyetur për situatën politike në vend, Namik Dokle, si përherë është i tërhequr, dhe përgjigjet shkurt, duke e konsideruar atë të zymtë si një mjegullë e plotë. I pyetur për deklaratën e tij në vitin 2002 kur dha dorëheqjen, e tha se mafia po pushton pushtetin, Dokle tha se nuk ka ndryshuar shumë nga ajo kohë, dhe disa njerëz kanë kapur gjithçka.

Z. Dokle, ju vini për lexuesin shqiptar me një libër të ri, artistik, të titulluar “Vajzat e mjegullës”. Kush janë “Vajzat e mjegullës”?

Vajzat e mjegullës janë të gjitha vajzat që janë viktimë të kohës së tyre. Ky është pikërisht koncepti i romanit që kam shkruar, sepse nisem nga parimi që misioni i historisë, nuk është që të shkruajë për ata që bëjnë historinë, por për ata që janë viktimë të historisë apo të njerëzve që bëjnë historinë. Viktimë mund të jetë një njeri, një komunitet njerëzish, krahinë, një vend apo një kontinent i tërë, siç ishte Evropa në Luftën e Dytë Botërore. Nga kjo pikëpamje, vajzat e mjegullës mund të jetë edhe një plakë e cila dikur ka qenë vajzë, apo një grua e moshës së mesme. Pra, është në kuptimin që mund të jetë vajzë, por edhe mund të jenë djem, që kanë qenë viktimë të historisë. “Vajzat e mjegullës” janë gjithë ngjarjet e mjegullta të jetës sonë. Në

roman, ka dhe një element konkret, sepse krahina që përshkruaj unë, është një krahinë të cilën e kam jetuar, ka ca tradita paksa të veçanta, sidomos në organizimin e dasmës dhe të Shëngjergjit. Tre muaj para festës së Shën Gjergjit, të gjitha vajzat e fshatit merren dhe çohen në një aksion, dhe fshati pret vajzat të kthehen për të festuar Shën Gjergjit, se pa ato, thotë njëri nga personazhet “Nuk çelin as lulet”. Në Roman, vajzat janë simbol i mjegullës në të cilën jetojmë, por nga ana tjetër dhe simbol i së bukurës dhe së mirës që presim çdo ditë të jetës sonë të ndodhë. Kjo është dhe simbolika e pritjes “a do të vijmë vajzat”. Nën këtë pritje zhvillohen të gjitha ngjarjet e tjera të romanit. Vajzat janë edhe mjegulla të cilën ne e vuajmë, por edhe rreza e diellit të cilën ne e presim.

Ku zhvillohen ngjarjet në romanin tuaj dhe kush janë protagonistët e “Vajzave të mjegullës”?

Ngjarjet zhvillohen në krahinë



e Gorës. Gora është një krahinë me 29 fshatra, por ka qenë një viktimë e historisë ashtu siç ka qenë edhe e gjithë Shqipëria. Edhe Gora është e ndarë në tre shtete. 18 fshatra ishin nën Serbi, por sot për fat të mirë janë në Kosovë, ka 9 fshatra në Shqipëri, dhe 2 në Maqedoni. Është një realitet kompakt, por që është i ndarë në 3 shtete. Shkrimtari Zija Çela, në një shënim në kopertinën e librit ka shkruar: “Ka raste kur shkrimtari mund të thotë: kjo është tema ime dhe e kurrkujt tjetër. Rasti i romanit të Namikut është pikërisht ky”. Unë kam shkruar për një botë që e kam njohur, ku jam rritur, dhe aty ka natyrisht dhe elementë biografikë, jo aq të jetës sime sesa të atyre që unë kam njohur në komunitet. Ka


Politika

TËRHEQJA

Unë kam vendosur të mos rikandidoj më për deputet. Kur një deputet sipas Kushtetutës hap seancën e parë të parlamentit të sapozgjedhur, kjo do të thotë se epoka e tij parlamentare ka mbaruar.

MAFIA

Një lloj grupimi njerëzish po sekuestrojnë politikanë, balerina, biznesmenë, intelektualë, etj. Për fat të keq, ne sot nuk i kemi shpëtuar ende kësaj. Kjo situatë ka vijuar prej vitesh në Shqipëri.



ndonjë personazh aty edhe me emrin e vërtetë të tij, ka dhe të tjerë që janë produkt i fantazisë dhe të laboratorit krijues të shkrimtarit.

Kush është “filli i kuq” i zhvillimit të subjektit të romanit tuaj?

Romanin unë e kam konceptuar si një mozaik. Ngjarjet në roman nuk i tregon vetëm autori. Ato i tregon autori, pjesërisht i tregon një fëmijë 13-vjeçar, pjesërisht i tregon një plakë të cilën e konsiderojnë 300 vjeçe, sepse është mbartësja e të gjithë kujtesës së asaj çka ka ndodhur. Narratorët e romanit janë të përzier me njëri-tjetrin, por synojnë të arrijnë mozaikun e një jete e cila është një jetë e trishtuar, por që ka shpresën dhe besimin se nesër do të bëhet më mirë. Një detaj: është një fëmijë dhe është edhe një plakë. Këtë plakë fëmija me naivitetin e tij e konsideron si 300 vjeçe nga ato çka dëgjon prej saj. Në një moment ai i kërkon t'i mësojë magjitë që ajo bën. Dhe ajo i thotë: “Jo mor bir, mi lër mua

këto magji. Magjia jote është shkolla”. Pra, mesazhi është që ti nuk mund të bësh atë që kanë bërë paraardhësit, pasi koha kërkon diçka tjetër, dhe ti do të bësh atë çka kërkon koha jote. Ngjarjet zhvillohen në vitet 50, në një situatë të privacioneve dhe ekonomike e kulturore, ku njerëzit përziën misrin me tërshërën nga mungesa e ushqimeve, aq sa mulxhiu që bluan drithin i thotë të voglit: “Me këtë që po sillni këtu, do të hingëllini të gjithë”. Këto detaje janë edhe sot. Ne kemi një hendek të madh mes të pasurve që pasurohen me shpejtësi marramendëse, dhe të varfërve që po varfërohen akoma edhe më shumë. Dua të përmend një personazh tjetër, që është Xhaxhai i personazhit kryesor fëmijës..

Personazhet

Personazhet nuk kanë emra. Ai quhet

Xhaxhai, dhe as fëmija nuk ka emër.

Fëmija tregon në vetën e parë. Ka nga ata që më thonë: je ti? “Jo” i them unë.

Diku jam unë, diku je ti. Diku është dikush tjetër.

Koha

Po të jesh deputet dhe të merrësh me biznes, nuk të pyet njeri ku e gjen kohën. Po të merrësh me pislëqe, nuk të pyet njeri ku e gjen kohën, ndërsa po të shkruash libra, të pyesin se ku e gjen kohën.





Namik Dokle: Nuk rikandidoj më, politika sot një mjegull

Deputeti i PS-së: Akoma nuk jemi çliruar nga njerëzit e mafies që kanë kapur gjithçka

Kur do të jetë takimi juaj i parë publik me lexuesin?


Takimi i parë do të jetë në datën 11, kur hapet panairi i librit. Pas inaugurimit unë do të jem në stendën e shtëpisë botuese Toena, për të kontaktuar me lexuesin, e ndërkohë, do të jem në datën 13 po në këtë stendë, në Pallatin e Kongreseve, në orën 18:00, do të bëhet edhe promovimi zyrtar i librit, ku do të ketë dhe bashkëbisedime me lexuesit. Tre ndihmësit e mi për ta shkruar këtë libër, është Xhaxhai im, tek ditari i të cilit jam bazuar, dhe shkrimtarët tanë të njohur, miqtë e mi Kiço Blushi dhe Zija Çela. Të dy më kanë ndihmuar më të vërtetë që të jem në brazdën e romanit.

A do të kemi në vijim, një libër me kujtimet tuaja, të pathëna të politikës?

Njerëzit pyesin: "More ti, ku e gjen kohën që shkruan libra". Është e çuditshme në Shqipëri. Po të jesh deputet dhe të merresh me biznes, nuk të pyet njeri ku e gjen kohën. Po të rrih në kafene gjithë ditën, nuk të pyet njeri ku e gjen kohën. Po të merresh me pislëqe, nuk të pyet njeri ku e gjen kohën, ndërsa po të shkruash libra, të pyesin se ku e gjen kohën. Edhe unë, si xhaxhai im, pa e ditur se ai mbante ditari, dhe unë kam mbajtur ditari gjatë gjithë jetës sime politike. Ndoshta do të merrem ndonjëherë me të për ta botuar, ose do ta hedh në koshin e kohës.

Kur ju keni dhënë dorëheqjen si kryetar i parlamentit, në vitin 2002, ju keni thënë "Mafia po pushtojnë pushtetin". I qëndroni sot kësaj deklaratë?

Madje po sekuestrohen kam thënë. Kam përmendur titullin e një libri të Gabriel Garsia Markezit "Njoftim për një sekuestro". Kam thënë që një lloj grupimi njerëzish po sekuestrojnë politikanë, balerina, biznesmenë, intelektualë, etj. Për fat të keq, ne sot nuk i kemi shpëtuar ende kësaj. Kjo situatë ka vijuar prej vitesh në Shqipëri, dhe unë mendoj që duhet bërë një luftë e madhe për ta kaluar këtë. Unë shoh me shpresë reformën në drejtësi, që shpresoj të bëjë diçka. Gjithmonë jemi duke pritur, siç prisnin personazhet e librit tim, rikthimin e vajzave.



ROMANI

Ngjarjet zhvillohen në vitet '50, në një situatë të privacioneve edhe ekonomike e kulturore, ku njerëzit përzienin misrin me tërshërën nga mungesa e ushqimeve, aq sa mullixhriu që bluan drithin i thotë të voglit: "Me këtë që po sillni këtu, do të hingëllini të gjithë". Këto detaje janë edhe sot...

Prej më shumë se dy vitesh, ju iu shmangeni në mënyrë konstante të gjithë interesit mediatic për çështjet politike. Pse kjo tërheqje?

Është një vendim personal. Unë kam vendosur të mos rikandidoj më për deputet dhe ta përmbyll këtë

jetën parlamentare. Kur një deputet sipas Kushtetutës hap seancën e parë të parlamentit të sapozgjedhur, kjo do të thotë se epoka e tij parlamentarë ka mbaruar dhe duhet tu lërë hapësirë të tjerëve. Seancën e parë të kësaj legjislaturore e kam hapur unë, sepse Saliu refuzoi. Ndryshe nga ai që ka vendosur të qëndrojë tërë jetën në parlament, unë kam vendosur të bëj të kundërtën. Nuk dua që legjislativën e ardhshëm parlamentare të jep po unë ai që do të hapë seancën si më i vjetri në moshë. Ky është gjykim personal, që do të thotë se unë nuk do të jem më në parlament, por nuk do të thotë se do të shkëputem përfundimisht nga politika.

Ju i vini publikut si shkrimtar, por nuk i shpëtoni kostumit tuaj politik. Si e vlerësoni situatën politike të tanishme?

Situatën politike do ta vlerësoja me gjysmën e titullit të librit tim "Vajzat e mjegullës". Në situatën e sotme vajzat mungojnë, ndërsa mjegulla është e plotë.

Që quhet?

Personazhet nuk kanë emra. Ai quhet Xhaxhai, dhe as fëmija nuk ka emër. Fëmija tregon në vetën e parë. Ka nga ata që më thonë: je ti? "Jo" i them unë. Diku jam unë, diku je ti. Diku është dikush tjetër. Xhaxhai i librit është shumë afër realitetit, pasi unë kam pasur një xhaxha i cili për 20 vjet me radhë ka mbajtur një ditari për të gjitha ngjarjet e fshatit. Unë e kam ndryshuar emrin e fshatit, pasi nuk kam dashur të lokalizohem në fshatin e lindjes sime. Ditari është mbi 500 faqe, nga të cilat është shfrytëzuar vetëm 20 faqe prej meje, me redaktimet përkatëse. Frymëzimin e parë e kam marrë nga ditët kur në fshat kishin ikur vajzat dhe ai kishte shkruar vetëm një fjalë: "Sa i trishtuar është fshati pa vajza". Vajzat u morën të gjitha në akcion për ndërtimin e hidrocentralit të Ulzës, dhe nuk u la asnjë vajzë në fshat. Dhe një familje që e martoi vajzën vetëm që ajo të mos shkonte në akcion, i morën motrën më të vogël. Një familje që nuk pranoi t'i çonte vajzat në akcion, u arratis komplet. Vetëm për këtë arsye. Zakonisht tharmin e çdo gjëje që shkruaj e kam marrë tek një ngjarje e së vërtetës. Ky element i së vërtetës është përzierë dhe me fantazinë krijuese.

Cili është lexuesi ideal i këtij libri? Kë keni pasur ju ndërmend kur e keni shkruar atë?

Ndoshta dhe një adoleshent do ta kuptonte, sepse personazhi kryesor që e vërtetë librin aty është një adoleshent. Ndërkohë mund ta kuptojë dhe një intelektual, sepse një nga personazhet e tjerë qendrorë është një intelektual, një mësues-poet, që në kërkim të lirisë së tij krijuese, ai bie viktimë e kohës dhe pushkatohet.



Fondi i investimit

"Ne do të bëjmë të mundur që në ciklin e tre viteve të jetë në dispozicion të çdo sipërmarrësi dhe fermeri që ka një projekt, një fond prej 300 milionë eurosh. Fondi bwhet efektiv nga Janari 2016"

LEONARD QUKU
TIRANE

Qeveria do të investojë në 3 vitet e ardhshme 300 milionë euro, fond i cili do të jetë në dispozicion të fermerëve dhe sipërmarrësve agrobujqësorë". Ky është premtimi i kryeministrit Edi Rama për fermerët, duke lanuar programin e ri të qeverisë në mbështetje të sektorit bujqësor. Gjatë inspektimit të një fabrike të përpunimit të fruta-perimeve në Lushnje, investim i ardhur si rrjedhojë e përfutur nga skemat mbështetëse të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor, kreu i qeverisë tha se fondit prej 300 milionë euro do të bëhet efektiv duke nisur nga janari i vitit të ardhshëm. "Ne do të bëjmë të mundur që në ciklin e tre viteve të jetë në dispozicion të çdo sipërmarrësi dhe fermeri që ka një projekt, një fond prej 300 milionë eurosh. Duke bërë të mundur që ajo që sot është tek kufizuar për shkak të buxhetit tek AZHBR-ja, të jetë tanimë shumë më e zgjeruar si mundësi", u shpreh Rama. Kreu i qever-



Rama: Nga 2016-a, investojmë 300 mln euro në bujqësi

"Fermerët do të marrin kredi lehtësuese, për projektet e veçanta qeveria do të paguajë huanë dhe interesat"

isë sqaroi se shteti do të jetë garant i fermerëve në banka të cilët do të marrin kredi me kushte lehtësuese, ndërsa për projektet e veçanta, do të jetë qeveria ajo që do të paguajë

krejtësisht huanë, përfshirë edhe interesat. "Nuk do të shkojnë fermerët tek banka, por do të shkojnë shteti në emër të tyre tek banka dhe fermerët do të marrin kredi

me kushte shumë lehtësuese, jo siç do t'i merrnin sot, ose siç i kanë marrë ata që kanë shkuar në bankë, me kushte tregtare, por me kushte shumë lehtësuese. Për pro-

Kredi lehtësuese

"Nuk do të shkojnë fermerët tek banka, por do të shkojnë shteti në emër të tyre tek banka dhe fermerët do të marrin kredi me kushte shumë lehtësuese, jo me kushte tregtare si sot, por shumë lehtësuese"

jekte të veçanta, ne do të paguajmë krejtësisht edhe të gjithë interesat", tha ai. Përmes programit të ri, qeveria synon të nxisë procesin zinxhirë të prodhimit, në mënyrë që fermeri të ketë të garantuar shitjen përmes grumbulluesit. Sipas kryeministrit, formula siguron çdo fermer që të ketë të garantuar shitjen e produktit të tij. "Çdo bujk e fermer që ka tokën e vet të jetë pjesë e sistemit dhe i gjithë procesi që nga punimi i tojës, tek mbjellja, korja, grumbullimi, përpunimi, paketimi dhe eksportimi të jetë një proces i plotë dhe një cikël i mbyllur që i jep mundësi atyre që punojnë tokën të mos jetë me ankthin se ku do ta shesë prodhimin, por që në momentin e parë janë të orientuar duke ju vënë në dispozicion farat dhe teknologjinë dhe duke ju thënë përkundër kësaj sasive prodhim, kjo është pagesa", theksoi Rama.

Gjithashtu, kryeministri vizitoi edhe një pikë në ndërtim të grumbullimit e të magazinimit të produkteve bujqësore, një investim shumë i rëndësishëm në Lushnje, që pritet të përfshijë në aktivitetin e saj rreth 10 mijë fermerë.

LAJME shkurt



PDIU: Të njihen pensionet me Italinë dhe Greqinë

Deputeti i PDIU-së, Omer Mamo, kërkoi dje nga Ministria e Mirëqenies Sociale nënshkrimin e marrëveshjeve për njohjen e ndërsjellët të viteve të punës për efekt pensioni mes Shqipërisë, Italisë dhe Greqisë. "Kemi mijëra shqiptarë në këto dy shtete të cilët i kanë kontributet të ndarë ndër vite mes dy vendeve dhe rrezikojnë pensionin në të dy vendet", tha Mamo në Komisionin Parlamentar të Çështjeve Sociale. Edhe kryetarja e komisionit, demokratja Albana Vokshi e mbështeti këtë kërkesë.

Presidenti izraelit vizitë në Shqipëri

Ambasadori i Shqipërisë në Izrael, Bardhyl Canaj, i paraqiti Letrat Kredenciale Presidentit të Shtetit të Izraelit, Reuven Rivlin. Nw takim Presidenti dhe Ambasadori vlerësuan kontributi dhe sakrificat e popullit shqiptar për shpëtimin e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Presidenti izraelit mirëpriti propozimin e Ambasadorit Canaj, për një vizitë zyrtare në Shqipëri, vitin e ardhshëm, në kuadër të 25 vjetorit të vendosjes së marrëdhënieve diplomatike.



Djegia e flamurit grek në Sarandë, Dule takon Tahirin

Kreu i PBDNJ-së, Vangjel Dule u takua pasditen e djeshme me ministrin e brendshëm, Saimir Tahiri, lidhur me djegien e flamurit kombëtar grek në selinë e "Omonia-s" në Sarandë. Sipas komunikatës për shtyp të nga PBDNJ, Duke është takuar me Tahirin për t'i shprehur shqetësimet për këtë ngjarje, të cilën e cilëson si akt urrejtjeje që nuk përfaqëson kurrsesi ndienjat e miqësisë dhe respektit të popullit shqiptar, si ndaj minoritetit etnik grek ashtu edhe ndaj popullit grek.

Fushata

TIRANE

Lulzim Basha: Injektojmë në ekonomi gjysmë miliardë euro

Ankohen punonjësit e rafinerisë së Ballshit: Kemi 4 muaj pa u paguar

marrë rrogat. "Kemi 4 muaj pa rroga dhe ky fut në burg njerëzit më të varfër në botë. Me 5 mijë lekë drita më ka futur mua në burg dhe katër muaj s'më jep rrogën. Se ne kemi nga 40 vjet, kemi lënë

eshtrat këtu. Le se na quan moshën sa i do qejfi atyre portani na lë edhe pa bukë. Këtë ta ketë parasysh. Ne jo revoltë do të ngrihem por ne do të bëjmë atë që ai do të flasë me vete", u shprehën punonjësit.

Për kreun e PD, kjo situatë është rrjedhojë se të ardhurat përfundojnë në xhepat e pushtetarëve. "Vetëm nga dogana në një ditë këta vjedhin sa për paguar gjithë punëtorët me rrogë të plotë për dy muaj.

Vitin e kaluar Shqipëria ka nxjerrë 1 milionë e 200 mijë ton naftë, i bie minimalisht 800 milionë euro".

Ndërkaq, gjatë takimit me tregtarët e Ballshit, Basha tha se qeveria po i trajton qytetarët si skllav të saj. Tregtarët i thanë Bashës se ka rënë ndjeshëm fuqia blerëse dhe se vështirësitë e tyre ekonomike, sa vijnë e thellohen. Kreu i PD premtoi se për tregtarët ambulants, taksat do të hiqen gjatë qeverisjes së demokratëve. "Sot 10 mijë lekë kam bërë xhiro, me të shënuara se kështu për të shitur ju, 5 mijë lekë, 10 mijë lekë. Shtetit i përgjigjemi, kasa ka me vite, tatimorët që po na vijnë po na gjejnë në rregull po puna është se ne s'kemi punë", tha një nga shitësit. "Ne për ambulantët taksat do t'i heqim. Një lekë në vit do të jetë taksa për ambulantët sepse ju, siç e the dhe vetë, mezi nxirni bukën e gojës", premtoi Basha.



Lulzim Basha në Mallakastër

► Premtimi

"Propozojmë ta nisim me një paketë të re taksash taksat me të ulëta në Ballkan sepse shqiptarët janë sot populli më i varfër në Ballkan do apo nuk do ta shohë kokoshi 200 milionësh"

► Pagesat

"Kemi 4 muaj pa rroga dhe ky fut në burg njerëzit më të varfër në botë. Me 5 mijë lekë drita më ka futur mua në burg dhe katër muaj s'më jep rrogën. Se ne kemi nga 40 vjet, kemi lënë eshtrat këtu"

Pas prezantimit të programit ekonomik një ditë më parë, dje kryetari i PD, Lulzim Basha u shpreh nga Ballshi se pasi të vijë në pushtet, do të akordojë 500 milionë euro në vit për ekonominë dhe punësimin. Në vijim të turit "Fjalën e kanë qytetarët", lideri i opozitës u takua me tregtarët dhe punonjësit të rafinerisë së naftës në Ballsh, të cilëve iu premtoi se kryefjalë e platformës së tij ekonomike, është ulja e taksave, me synim shndërrimin e Shqipërisë në vendin me taksat më të ulëta në Ballkan dhe injektimi çdo vit në ekonomi i gjysmë miliard euro. "Propozojmë ta nisim me një paketë të re taksash taksat me të ulëta në Ballkan sepse shqiptarët janë sot populli më i varfër në Ballkan do apo nuk do ta shohë kokoshi 200 milionësh. Duke ulur taksat ne i kthejmë shqiptarëve 500 deri në 600 milionë euro në vit", u shpreh Basha. Gjatë bashkëbisedimit, punonjësit e rafinerisë së naftës në Ballsh i ankuar Bashës se gati 1000 punonjës kanë 4 muaj pa

Reforma në Drejtësi e vonuar për shkak të dëshirës së qeverisë së shkuar

Manjani dekretohet nga Nishani, Meta: Impuls i ri, lëvizje pozitive për drejtësinë

ESIONA KONOMI
TIRANE

Një ditë pas rokadës brenda LSI-së që zëvendësoi ministrin e Drejtësisë, nga Nasip Naço, tek Ylli Manjani, Rama dhe Meta kanë komentuar ndryshimet që do të pasojnë për reformën në drejtësi. Gjatë konferencës së përbashkët për shtyp me ambasadorin e BE-së në Tiranë, kryeministri Edi Rama tha se reforma në drejtësi nuk ka të bëjë me emra të përvëqem. I pyetur nëse ndryshimi në qeveri ka të bëjë me reformën në drejtësi, Rama tha se kjo reformë është e vonuar dhe theksoi se ka ardhur nga "dëshira e qeverive të kaluara për të bashkëjetuar në mëkat". "Reforma në drejtësi është një reformë

TAKIMET

"Impulset e reja", Ylli Manjani te Edi Rama, Nasip Naço te Ilir Meta



Nasip Naço

Kryeministri Edi Rama ka zhvilluar mesditën e djeshme në Kryeministri një takim me disa prej ministrave të kabinetit, si dhe kandidatin zyrtar për postin e Ministrit të Drejtësisë, Ylli Manjanin, kur ende nuk kishte marrë dekretimin. Rama ka pritur në Kryeministri, Ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri, Ministrin e Shëndetësisë Ilir Beqajn, Ministrin e Zhvillimit urban dhe Turizmit, Eglantina Gjermeni si dhe Ylli Manjanin. Ndërkohë po dje rreth orës 13:10, ministri i dorëhequr i Drejtësisë, Nasip Naço ka zhvilluar një takim me kryeparlamentarin, Ilir Meta në kryesinë e Kuvendit. Takimi mes tyre vjen një ditë pasi Naço dha dorëheqjen.



Edi Rama dhe Ilir Meta

madhore, e shumëzvarritur për shumë vite. Mungesa e vizionit, mungesa e kurajës, e vendosmërisë, por edhe le ta themi copë dëshira për të bashkëjetuar në mëkat, e qeverive të mëparshme, qeverisë së mëparshme me gjykatësit e korruptuar, sot kërkon një përgjigje të qartë popullore, kombëtare dhe shtetërore. Pra madhësia dhe kompleksiteti i reformës në drejtësi nuk ka sesi të lidhet me një emër të përvëqem qoftë ky dhe emri im", deklaroi Rama. Ndërsa për ndryshimin e ministrit të Drejtësisë dhe nëse kjo i hap rrugën ndryshimeve të tjera në qeveri, Meta tha se ky ndryshim do t'i japë impulse të reja jo vetëm sa i takon reformës në drejtësi por edhe sa i takon luftës së korruptacionit dhe rritjes së transparencës. "Pa diskutim që ky ndryshim për të cilin duhet të falënderoj

z. Naço që i hap rrugën këtij ndryshimi, absolutisht që do t'i shërbejë impulseve të reja jo vetëm sa i takon reformës në drejtësi dhe rritjes së transparencës dhe rolit të ministrisë së Drejtësisë, por edhe në luftën

dekreteve të njëpasnjëshme kreu i shtetit Bujar Nishani pranoi kërkesat e kryeministrit Edi Rama, atë të dorëheqjes së Naços dhe propozimit në këtë post të Manjanit. Me këtë dekret i hapet rrugë votimit të Parlamentit të propozimit të Manjanit si ministër i ri i Drejtësisë, për tu dekretuar më tej nga Nishani deri në ceremoninë e betimit si anëtarë më i ri i kabinetit qeveritarë në mazhorancën e koalicionit PS-LSI. Naço i paraqiti dorëheqjen kryeministrit Edi Rama përmes një letre ku fliste për nevojë të një bashkëpunimi në nivel më të lartë dhe bashkëpunimit të gjithë aktorëve në reformën në drejtësi.

"Madhësia dhe kompleksiteti i reformës në drejtësi nuk ka sesi të lidhet me një emër të përvëqem qoftë ky dhe emri im"

ndaj korruptacionit dhe mendoj se është një lëvizje mjaft pozitive", u shpreh Meta. Po dje, Presidenti i Republikës Bujar Nishani dekretoi shkarkimin e ministrit të Drejtësisë Nasip Naço dhe emërimin në këtë post të nënkryetarit të LSI-së Ylli Manjani. Përmes dy

LAJME SHKURT

PD: Zjarri në laborator, krimi më i rëndë shtetëror në dy dekada

Partia Demokratike ka vijuar akuzat ndaj ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri dhe kryeministrit Edi Rama për zjarrin që ra në laboratorin kriminalistik disa ditë më parë. "Djegia e provave për bandat e trafikut të drogës brenda laboratorit kriminalistik është padyshim një nga krimet më të rënda shtetërore në dy dekadat e fundit", deklaroi dje nga selia blu Enkelejd Alibeaj, drejtor i departamentit për Rëndin dhe Sigurinë Publike në PD. Alibeaj i bëri thirrje prokurorisë të bëjë hetime energjike "e pandikuar nga Saimir Tahiri dhe Edi Rama, që janë vetë të përfshirë në këtë krim të madh".




Kryetarja e FRESH: PS promovon zhvillimin ekonomik rajonal

Forumi i Dytë i Liderëve të Rinj u zhvillua gjatë javës së shkuar në Pekin. Forumi bëri bashkë të rinj nga 16 vende të Europës Qëndrore dhe Lindore, mes tyre edhe përfaqësues të FRESH dhe LSI. FRESH, pjesëmarrës për herë të dytë në Forumin e liderëve të rinj të Kinës dhe Europës Qëndrore e Lindore, këtë vit u përfaqësua nga Kryetarja e Forumit Joleza Koka. "PS ka përgjegjësinë e madhe të promovojë zhvillimin ekonomik e social lokal dhe rajonal. Liderat e rinj duhet të bashkohen të gjithë njëzëri në rrugën e zhvillimit dhe paqes së qëndrueshme", citohej të ketë thënë Koka gjatë punimeve të forumit.

Spartak Braho: Brenda dhjetorit, kabineti i rifreskuar

Pas lëvizjes në Ministrinë e Drejtësisë, deputeti i Lëvizjes Socialiste për Integrim, Braho flet për ndryshime të tjera në kabinetin qeveritar, që brenda dhjetorit pritet të jetë i rifreskuar. "Këto janë impulse jo vetëm për ato që ka thënë kryetari Meta, por edhe për ato që ka thënë edhe kryeministri Rama. Burri luan, guri s'luan. Shpresojmë edhe për ndryshime të tjera. Gradualisht brenda këtij viti besoj se do ketë edhe përmirësime të tjera", deklaroi dje deputeti Spartak Braho për mediat.



Presidenti Nishani dekreton Cahanin komandant të Forcave Tokësore

Presidenti Bujar Nishani, njëkohësisht Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, i dorëzoi dje në mesditë Nazmi Cahanin, Gjeneral Brigade, dekretin e emërimit si Komandant të Forcave Tokësore. Kreu i Shtetit i urroi Cahanin punë të mbarë dhe suksese në detyrën e tij të rëndësishme në krye të Forcave Tokësore të Republikës së Shqipërisë. Në këtë ceremoni ishte e pranishëm Ministria e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm Gjeneral Major Jeronim Baze, etj.



Vrasja e 22-vjeçarit, Ndocaj: Mbuloj shpenzimet gjyqësore

Deputeti më i ri i kuvendit, Eduart Ndoci, u takua dje me familjarët të 22 vjeçarit Gjergj Gjonit, i cili u vra nga një pensionist italian në Milano. Ndoci këmbuloi në premtinin e tij se do të gjedjë një avokat për të ndjekur këtë çështje në gjykata italiane dhe se do të mbulojë shpenzimet e procesit gjyqësor. 22 vjeçari u vra

pak javë më parë në Milano nga një pensionist italian. I moshuari pretendoi se e ka kryer vrasjen në kushtet e vetëmbrojtjes, por policia italiane nuk ka gjetur prova të mjaftueshme që mbështesin pretendimin e tij. Mediat italiane raportuan se Gjoni kishte punuar për italianin, por nuk ishte paguar.

SHPALLJE ANKANDI

Shoqëria Përbarimore "616/A" shpk, shpall shitjen në ankand për pasurinë "Truall + Ndërtesë", me sip. 250 m², nga të cilat 165 m² ndërtesë, me numër pasurie 14 / 73, vol. 16, fq.34, zk.8582, me adresë: Lagjia Nr.: 4, Pogradec.

Pasuria nxiret në ankand me vlerën filltare 4.416.000 (katërmilion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë Ankand zhvillohet ne date 04.12.2015.

Personat e interesuar mund te paraqiten ne adresen Lagjia nr.3, Rruga "Naim Frasheri", Pogradec ose te kontaktojne ne numrin 0697251504 ose ne e-mail: shoqeria616a@gmail.com

LORENC RABETA
TIRANE

Fondi Monetar Ndërkombëtar e ka "bekuar" aksionin masiv të Qeverisë kundër informalitetit. Në një konferencë të përbashkët për shtyp me Ministrin e Financave, të Ekonomisë dhe Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, përfaqësuesja e FMN Anita Tuludhar tha se masat e qeverisë në kuadrin e evazionit janë të drejta dhe po japin rezultat në ecurinë e ekonomisë. "Këto masa duhet të shihen si masa të drejta. Dhe këshillat që kemi dhënë janë që qeveria të ndjekë dhe cilat ka qenë praktika më e mirë kombëtare, por dhe që të ndihmohen tatimpaguesit që të përmbushin pagesat. Por përmbushja e pagesave nga subjektet është dhe e detyrueshme dhe jo vetëm për uljen e deficitit buxhetor. Po kështu edhe reforma energjetike. Kjo reformë ka ndihmuar në konsolidimin fiskal", tha Tuludhar.

CANI

Ndërsa paraqiti treguesit buxhetorë të diskutuar me FMN, Ministri i Financave tha se buxheti i vitit 2016 nuk do të rrisë taksat, por mund t'i ulë ato në disa sektorë. "Buxheti i vitit 2016 që u rakordua me FMN-në nuk do të befasojë kënd për arsye se siç kemi thënë, ky buxhet nuk rrit taksat, por mund të ulë taksat në sektorë të veçantë të ekonomisë, si në bujqësi, apo turizëm", tha Cani. Ministri theksoi se rritja ekonomike do të mbetet pranë parashikimit prej 2.7%, pavarësisht paqëndrueshmërisë së faktorëve të jashtëm. "Kanë ndikuar një sërë faktorësh. Në



SEKTORËT

Ndërsa paraqiti treguesit buxhetorë të diskutuar me FMN, Ministri i Financave tha se buxheti i vitit 2016 nuk do të rrisë taksat, por mund t'i ulë ato në disa sektorë



INVESTIMET

Ministri i Ekonomisë Arben Ahmetaj theksoi se masat e deritanishme të qeverisë do të finalizohen me rritjen e investimeve, të cilat në vitin 2016 mund të arrijnë edhe 800 milionë dollarë

besojmë se këta faktorë do vijnë edhe në pjesën e mbetur të vitit dhe do të ndikojnë në rritje të ekonomisë: jo vetëm për të arritur këtë objektiv por do shtrojmë shtratit edhe për rritje ekonomike më të madhe në vitin 2016", tha Ministri.

FMN "bekon" aksionin e qeverisë kundër evazionit

Cani: Ulim taksat, rritja ekonomike do të mbetet pranë parashikimit prej 2.7%



Konferenca e përbashkët me FMN

BORXHET

Ministri i Financave shtoi gjithashtu se deri në fund të vitit do të shlyhen tërësisht detyrimet e prapambetura ndaj biznesit. "Për detyrimet e prapambetura. Ne kishim objektiv për të shlyer në 3 vite gjithë borxhet e prapambetura të lëna për 8 vite nga qeveria e shkuar.

Me mbylljen e këtij viti ne mbyllim totalisht nivelin tërësor të detyrimeve të prapambetura të qeverisë së kaluar. Kemi thënë që janë 720 mln dollarë, po aq do të jenë detyrimet e shlyera në fund të këtij viti. Nga njëra anë krijuam mundësinë për likuiditet të biznesit, nga ana tjetër shlyem një de-

tyrim ligjor. Na lind e drejta që ne të kërkojmë atë që i takon buxhetit në dobi të shtetasve", tha Cani. Ministri shpjegoi edhe operacionin në tregjet ndërkombëtare për marrjen e Eurobondit prej 450 milionë eurosh. Sipas tij, qëllimi kryesor i këtij borxhi të jashtëm është nxitja e

bankave në vend të japin më shumë kredi, duke larguar vëmendjen nga financimi borxhit të brendshëm të qeverisë. Ndërsa Ministri i Ekonomisë Arben Ahmetaj theksoi se masat e deritanishme të qeverisë do të finalizohen me rritjen e investimeve, të cilat në vitin 2016 mund të arrijnë edhe 800 milionë dollarë.

BSH

Sejko: Problem konsumi i ulët e kreditë e këqija



Në fjalën e tij, Guvernatori Gent Sejko vuri në dukje se është pasiguria ajo që vijon të frenojë investimet, duke theksuar konsumin e dobët dhe nivelin e kreditë të këqija, si çështje kyçe të zhvillimit ekonomik. Guvernatori Sejko tha ndër të tjera se inflacioni do vijojë të qëndrojë poshtë nivelit 3%, ndërkohë që Banka e Shqipërisë uli përsëri normën bazë të interesit në 1,75% për të nxitur konsumin. Sipas tij, ritmi i rritjes ekonomike është ende i pamjaftueshëm, por ka përmirësim të klimës së biznesit.

Çfarë pengon lotarinë e kuponave?

NGA **Genc Kondi**

Para dy vjetësh Financat njoftuan objektivin e tyre për të aplikuar një metodë të efektshme, pa përdorur policë, tatimorë e burgje, për të detyruar përdorimin e kuponave fiskalë të shitjes. Deri më sot, një gjë e tillë nuk është realizuar.

Të bën përshtypje një lajm i sotëm i gazetës kosovare "Telegraf". "Gjatë muajit tetor dhe javës së parë të nëntorit interesimi i qytetarëve ka qenë tejet i madh për dorëzimin e plikove me kuponë fiskalë për rimbursimin e parave për tremujorin e tretë të këtij viti (korrik-gusht-shtator). Sipas zyrtarëve të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) në tremujorin e tretë të këtij viti, ATK-ja ka pranuar 53.749 pliko me mbi 1 milion kuponë fiskalë. me vlerë mbi 14 milionë euro.

Projekti po vlerësohet si tejet i suksesshëm nga zyrtarët e ATK-së,

por edhe nga njohës të çështjeve ekonomike por ngrenë dyshime se do të zgjasë shumë kohë, për shkak të barrës së buxhetit.

Zyrtarja për informim në ATK, Blerta Nikqi, ka bërë të ditur për KosovaLive se interesimi i qytetarëve për dorëzimin e plikove me kuponë fiskalë për muajt korrik-gusht-shtator, krahasuar me tremujorin e dytë është rritur deri në 140%.

"Nga 19,640 pliko të verifikuara deri më 5.11.2015 nga ATK-ja, numri i kuponëve fiskalë arrin në 1,238,029, kurse vlera e tyre është 14,936,187.98 €. Kjo shifër tregon se qytetarët janë duke kërkuar kuponë fiskalë në të gjitha bizneset ku ata furnizohen me mall ose shërbim, çka ne si ATK presim nga qytetarët të vazhdojnë të kërkojnë kuponë fiskal nga bizneset ku kryejnë blerjen e mallrave apo shërbimeve", ka thënë Nikqi.

Sipas saj, ATK-ja e vlerëson lartë këtë proces, pasi që në pjesën e luftimit të informalitetit është i kyçur direkt qytetari i Kosovës".

Ministri i Financave, Avdullah



Hoti, në profilin e tij në Facebook, ditë më parë ka shkruar se nga ky projekt po zvogëlohet ekonomia

joformale, konkurrenca po rritet, po përfitojnë si qytetarët, bizneset e rregullta, ashtu dhe buxheti i

shtetit. Kjo, pasi qytetarët, sipas tij, janë të nxitur të blejnë produkte vetëm nga kompanitë, të cilat lëshojnë kuponë fiskalë.

Administrata fiskale e Kosovës aplikon shpërblime si më poshtë: Plikot me më shumë se 30 kuponë dhe me vlerë të përgjithshme nga 250 euro deri në 500 euro rimbursohen në vlerën 10 euro. Plikot me më shumë se 40 kuponë dhe me vlerë të përgjithshme nga 501 euro deri në 800 euro rimbursohen në vlerën 15 euro. Ndërsa plikot me më shumë se 50 kuponë dhe me vlerë të përgjithshme mbi 800 euro rimbursohen në vlerën 20 euro.

Jo më kot Kosova po na i kalon në renditjen "Doing Business". A nuk është me vend që lotaria, e premtuar si një formë alternative e shpërblimit, që do të shpërblente numra të caktuar të kuponave, të hedhur vazhdimisht me short, të vihej në zbatim? Thua që asnjë subjekt të mos ketë ofruar kërkesën për një koncesion të mundshëm në këtë drejtim, meqë administrata duket se është lodhur shumë nga aksionet...?

LORENC RABETA
TIRANE

Ministri i Transporteve Edmond Haxhinasto ka bërë publike ofertat e dy kompanive në garë për koncesionin e Rrugës së Kombit, të cilat, sipas tij, kanë propozuar tarifa më të ulëta se 5 euro për kalimin e saj. Deklarata e Ministrit është bërë gjatë një takimi me shoqatën e taksistëve të kryeqytetit ku diskutoi lidhur me zbatimin e planit kundër informalitetit. "Janë dy oferta për rrugën e kombit, nën asistencën e IFC-së që është pjesë e Bankës Botërore dhe mund të them që në këtë moment po realizohen disa sqarime për ofertën e kompanive. Shumë shpejt do të dalë komisioni me një vendim përsa i takon cilësisë së kësaj oferte, interesit publik të saj. Tarifa e propozuar është nën 5 euro", tha gjatë deklaratës për shtyp Ministri Haxhinasto.

KONCESIONI

Tenderi për dhënien me koncesion të Rrugës së Kombit tashmë ka hyrë në fazën përfundimtare të vlerësimit të ofertave dhe të përzgjedhjes së kompanisë fituese. Vlerësimi i ofertave, do të përcaktojë edhe tarifën përfundimtare që do të aplikohet për të kaluar në aksin MilotMorinë, ndërkohë që deri tani ishte përsëritur shpesh se do të jetë 5 euro. Objektiv i kryesor i këtij koncesioni është përmirësimi i autostradës, funksionimi dhe mirëmbajtja efektive e saj. Koncesioni do

OFERTAT
Shumë shpejt do të dalë komisioni me një vendim përsa i takon cilësisë së kësaj oferte, interesit publik të saj. Tarifa e propozuar është nën 5 euro, tha Ministri Haxhinasto



KOLAUDIMI
Haxhinasto i bëri thirrje koncesionarit të kolaudit të automjeteve, që të bëjë me shumë, në shmangien e radhëve dhe të luftojë korrupsionin mes punonjësve të saj

koordinimi mes institucioneve, për të ulur shifrën e lartë të informalitetit që ende vazhdon, duke theksuar se qëllimi kryesor nuk është rritja e gjobave, por rritja e shërbimeve dhe sigurisë. Ministri tha se kërkohet një koordinim më i mirë i punës nga ana e të gjithë shërbimeve që janë për monitorimin e sektorit dhe për vendosjen e rregullit në këtë sektor, që është edhe Shërbimi i Kontrollit, Policia e Shtetit, Bashkia e Tiranës, edhe bashkitë e tjera. "Këtë shifër të lartë të informalitetit që ekziston, me duhet ta ulim me të gjitha mjetet, sepse në fund të fundit nuk është çështja që ne garantojmë disa gjoba më shumë, por rregullimi i tregut, rregullon shërbimin ndaj qytetarit", tha Haxhinasto.

KOLAUDIMI

Ministri u ndal edhe te një video e shfaqur në media, ku një qytetar paguante për të kolauduar automjetin, duke thënë se menjëherë kompania koncesionare ka shkarkuar nga detyra 2 punonjësit e përfshirë. Haxhinasto i bëri thirrje koncesionarit të kolaudit të automjeteve, që të bëjë me shumë, në shmangien e radhëve dhe të luftojë korrupsionin. "Kësaj kompanie i janë kërkuar disa herë nga ana e ministrisë që të forcojë kontrollin dhe të luftojë korrupsionin në punonjësit e saj, i është kërkuar që procesi të kolaudit të automjeteve të jetë i tillë, që duke futur dhe teknologjinë e informacionit që të ketë sa më pak mundësi për subjektivizëm", tha Haxhinasto.

Haxhinasto: Tarifa e Rrugës së Kombit, nën 5 euro

Ministri takim me shoqatën e taksistëve të kryeqytetit për luftën kundër informalitetit

të zgjasë për një periudhë 30 vjeçare dhe kompania fituese do të mbledhë dhe të mbajë të ardhurat nga taksa dhe në këmbim do të ketë përgjegjësinë për të zbatuar dhe financuar përmirësimet e autostradës, të ndërtojë një urë të re mbi lumin Drin në Kukës dhe të zbatojë punimet më urgjente gjeoteknike të stabilizimit.


TAKSISTËT

Ministri i Transportit dhe



Infrastrukturës Edmond Haxhinasto ka zhvilluar dje një takim me shoqatën e taksistëve të kryeqytetit, duke diskutuar në lidhje me zbatimin e planit kundër informalitetit. Haxhinasto i lëshoi një apel drejtuesve të taksive që të përdorin taksimet, për të ofruar një shërbim sa më cilësor, të sigurt dhe me koston e duhur për qytetarët. Ministri i Transportit theksoi se duhet të forcohet

LAJME SHKURT



Fondet e investimit, frenohet rritja

Fondet e investimit vijuan një rritje të përmbytur edhe gjatë 3-mujorit të tretë të vitit, duke arritur një total aktivesh prej 68 miliardë lekësh. Sipas të dhënave nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, ky treg është rritur me rreth 4 miliardë lekë, ose 6.2% që nga fillimi i vitit. Ritmet e rritjes këtë vit paraqiten më të kufizuara se në të shkuarën dhe kjo lidhet sidomos me forcimin e kuadrit mbikëqyrës për këto institucione nga AMF. Deri këtë vit investimet e fondeve ishin përqendruar sidomos në obligacione, instrumente borxhi afatgjatë.

Ligi për procedurat tatimore, Malaj: Bien ndesh me Kushtetutën


Ish-ministri i Financave, Arben Malaj, shprehet se ndryshimet e miratuara në ligjin për procedurat tatimore që hyn në fuqi këtë javë bien ndesh me Kushtetutën e vendit. Përmes një postimi në rrjetet sociale, Malaj thotë se ndryshimi në nenin 122 të ligjit, që përcakton gjobë prej 10 milionë lekësh për bizneset që janë subjekt i tatimit-fitimit, shkon përtej masës administrative. Ai shton se sipas opinionit edhe të disa juristëve të konsultuar prej tij, gjoba që nuk lidhet me masën e dëmit përbën në vetvete dënim penal. Ndaj, një masë e tillë nuk mund të jepet nga administrata tatimore, por vetëm nga gjykatat.

Tregu valutor, Euro shënon nivelin më të ulët që prej vitit 2012

Euro ka shënuar një tjetër rënie të fortë dje në tregun e brendshëm, duke u këmbyer me 138.43 lekë, 0.29 lekë më pak se dy ditë më parë. Ky është niveli më i ulët i monedhës së përbashkët evropiane në tregun valutor vendas, referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë.



Rënia e euros në tregun vendas shpjegohet me zhvlerësimin e kësaj monedhe edhe në tregun ndërkombëtar. Dje, euro u këmbyer me 1.07 dollarë, niveli më i ulët në 6 muaj, si rrjedhojë e dobësisë së bursave europiane. Një tjetër arsye e rënies është edhe kërkesa e ulët e në tregun e brendshëm, sipas aktorëve të tregut.



10 majori, bie me 1% transporti i udhëtarëve në Portin e Durrësit

670.462 persona kanë udhëtuar me tragete gjatë 10 mujorit të këtij viti, sipas të dhënave nga Autoriteti Portual i Durrësit. Një shifër kjo, vetëm 1% më e ulët se e njëjta periudhë e vitit të shkuar. Sipas të dhënave, tragetet kanë kryer 78 lundrime më pak në këto 10 muaj. Afro 380 mijë udhëtarë janë nisur me tragete drejt porteve të Barit, Brindizit, Triestes dhe Ankonës (Itali), duke shënuar një rritje prej 4% krahasuar me të njëjtën periudhë të 2014-ës. Numri i shtetasve shqiptarë që kanë udhëtuar me tragete ka shënuar një rritje prej 4%, ndërsa, numri i shtetasve të huaj ka shënuar një rënie prej 14%.

MB hap tenderin për 87 ha tokë me qira në Karavasta



Ministria e Bujqësisë, duke iu përgjigjur interesit gjithnjë e në rritje për administrimin e lagunave, hapë së fundmi procedurën konkurruese për dhënien me qira të sipërfaqes së tokës prej 87 ha në Fshatin Karavasta, Njësia Administrative Rremas. Sipas njoftimit MB-së, vlera filltare e qirasë së tokës bujqësore në pronësi të shtetit për hapjen e procedurës konkurruese është 730.800 lekë në vit (8,400 lekë/ha/vit). Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data 07.12.2015, ora 11:00. Ministria lajmëron subjektet e interesuara që të kërkojnë informacion për procedurën konkurruese, pranë selisë së institucionit.

Të ardhurat nga kontributet, 9% më të larta se një vit më parë

Formalizimi duket se po jep efekt më të dukshëm të sigurimi i punonjësve. Sipas të dhënave paraprake, të ardhurat nga kontributet deri në 26 tetor ishin 5.2% më të larta se plani mujor. Nga 6.344 miliardë lekë, të ardhurat janë 331 milionë lekë më shumë. Ndaj tetorit 2014, të ardhurat

nga kontributet janë gati 9% më të larta. Megjithatë, edhe kjo shtesë duket e ulët, duke pasur parasysh se në skemë kanë hyrë rreth 80 mijë punonjës të rinj, sipas të dhënave zyrtare. Shqipëria vlerësohet sot se ka një rendiment të ulët të mbledhjes së kontributeve në rajon, me vetëm 4% të PBB-së.

Farmacistët, kujt i është miratuar leja e profesionit

UFSH publikon listën e farmacistëve në të gjitha qaqet, ku do të tërhiqet leja. Ricertifikimi për fazën II

DRICIM ÇAKA
TIRANE

Janë 425 farmacistët që u është miratuar leja e re për ushtrimin e profesionit. Urdhëri i Farmacistëve ka publikuar listën në 12 qarqe të vendit. Këta farmacistë duhet të tërheqin kartën e re pas programit të ricertifikimit që është zhvilluar në vitet

2010-2014. Lejet e reja për farmacistët janë lëshuar pasi kanë përmbyshur detyrimin për mbledhjen e krediteve. Janë rreth 358 farmacistë që u është miratuar leja e re profesionit në Tiranë, ndërsa 67 të tjerë janë nga 11 qaqet e tjera. UFSH bën me dije se lejet e miratuara janë për muajt shtator-nëntor.

CIKLI I RI

Farmacistët tashmë duhet të mbledhin një

numër tjetër kreditesh deri në vitin 2019-t. "Cikli i ri i ricertifikimit do të përfshijë farmacistët dhe ndihmësfarmacistët. Ky cikël i ricertifikimit do të zgjasë 4 vjet, brenda të cilit duhet të përfitonë 60 kredite. Numri minimali krediteve të domosdoshme brenda një viti është 5. Secili farmacist apo ndihmësfarmacist duhet që më shumë se 50% të krediteve t'i përfitojë nga aktivitetet e zhvilluara brenda specialitetit. Me

anë të edukimit në distancë nuk mund të përfitohen më shumë se 50% të krediteve. Me anë të vetëraportimit të literaturës së lexuar nuk mund të përfitojnë më tepër se 20% të krediteve", - thotë Urdhri i Farmacistëve.

KUSH PËRJASHTOHET

Nga cikli i dytë për mbledhjen e krediteve përjashtohen ata profesionistë, të cilët dalin në pension brenda periudhës 4-vjeçare të ciklit dhe që nuk



Karta
Janë rreth 358 farmacistë që u është miratuar leja e profesionit në Tiranë, ndërsa pjesa tjetër janë nga qaqet e tjera

do të vazhdojnë ta ushtrtojnë profesionin e tyre në sektorin privat. Profesionistët, të cilët gjatë një viti kalendarik të ciklit të programit ndërpressin punën për një periudhë 4-mujore ose edhe më gjatë dhe farmacistët që punojnë në administratë.

FARMACISTEVË QË U ËSHTË MIRATUAR LEJA E PROFESIONIT


TIRANE		Pellumbi		Flutura		Shema		Luljeta		Fejzullari		Tania		Shana		Naziona		Malka		Jorida		Kollçaku	
EMRI	MBIEMRI	Ivis	Koliqi (Vathi)	Emelda	Shehaj	Emelda	Shehaj	Diana	Dragoj (Lama)	Tanja	Beqari	Tanja	Beqari	Nesrina	Memishi	Nesrina	Memishi	Jorida	Kollçaku	Lumturije	Shabani	Kollçaku	(Katundsi)
Eriola	Caushi (Vangjeli)	Hamit	Sita	Aferdita	Rasa	Aferdita	Rasa	Artan	Çene	Thomaidha	Nako	Thomaidha	Nako	Sofije	Alushaj	Sofije	Alushaj	Lumturije	Shabani	Qefsera	Kovaçi	Kollçaku	(Katundsi)
Arjola	Gabrani	Olisi	Çaushi	Elona	Hysemi	Elona	Hysemi	Flavia	Hoxha	Vjollca	Boçi	Vjollca	Boçi	Keti	Gushi	Keti	Gushi	Arben	Dulaj	Sadete	Lami (Spahiu)	Enkelona	Guza
Mariana	Kruetani (Mecollari)	Ejona	Rudi	Hatixhe	Zagradi	Hatixhe	Zagradi	Florida	Poliçi	Vjollca	Anadolli	Vjollca	Anadolli	Kumrije	Çitizi	Kumrije	Çitizi	Enkelona	Guza	Mariana	Kruetani (Mecollari)	Enkelona	Guza
Vera	Toci (Sala)	Rezarta	Gumeni (Ajazi)	Ermina	Driçi	Ermina	Driçi	Arton	Koxhaj	Vjollca	Dibra	Vjollca	Dibra	Efelinia	Dhimitriadhi	Efelinia	Dhimitriadhi	Enkelona	Guza	Vera	Toci (Sala)	Enkelona	Guza
Farie	Meta (Gjoka)	Brisilda	Qafa (Petriti)	Anisa	Murataj	Brisilda	Qafa (Petriti)	Erjona	Hysa	Vjollca	Panajoti	Vjollca	Panajoti	Gledia	Xhako	Gledia	Xhako	Enkelona	Guza	Farie	Meta (Gjoka)	Enkelona	Guza
Redi	Shpendi	Iva	Erindi	Endri	Hoxha	Iva	Erindi	Evisa	Gjini	Xhelona	Alia (Stermasi)	Xhelona	Alia (Stermasi)	Enrieta	Priti	Enrieta	Priti	Enkelona	Guza	Redi	Shpendi	Enkelona	Guza
Fatos	Mollosmani	Gentjan	Mataj	Greta	Spaha	Gentjan	Mataj	Pamela	Perri	Ylli	Doko	Ylli	Doko	Ermira	Hasko	Ermira	Hasko	Enkelona	Guza	Fatos	Mollosmani	Enkelona	Guza
Aferdita	Mollosmani	Ardiana	Çapi	Eriona	Petru	Aferdita	Mollosmani	Edis	Sevo	Ylli	Myderizi	Ylli	Myderizi	Jeta	Shehu	Jeta	Shehu	Enkelona	Guza	Aferdita	Mollosmani	Enkelona	Guza
Elona	Zyla (Skenderi)	Aurora	Picari (Buba)	Liontin	Karalliu	Elona	Zyla (Skenderi)	Fatjon	Memeti	Ylli	Mekollari	Ylli	Mekollari	Zize	Derri	Zize	Derri	Enkelona	Guza	Elona	Zyla (Skenderi)	Enkelona	Guza
Sashenka	Hoxha (Shehu)	Elga	Gogu	Matilda	Abulkehr	Sashenka	Hoxha (Shehu)	Rovena	Lato	Ylber	Fortuzi	Ylber	Fortuzi	Marta	Marku	Marta	Marku	Enkelona	Guza	Sashenka	Hoxha (Shehu)	Enkelona	Guza
Elisabeta	Likaj (Ibrahimi)	Aida	Keci (Zaka)	Benuarda	Toto	Elisabeta	Likaj (Ibrahimi)	Bianka	Progri	Andrea	Matua	Andrea	Matua	Violeta	Xhyra	Violeta	Xhyra	Enkelona	Guza	Elisabeta	Likaj (Ibrahimi)	Enkelona	Guza
Fatmira	Jahja (Berisha)	Klarita	Hoxhallari (Kalemi)	Eida	Kalefi (Çaçi)	Fatmira	Jahja (Berisha)	Kristulla	Kotorri	Anjeza	Kalci	Anjeza	Kalci	Albert	Gushi	Anjeza	Kalci	Enkelona	Guza	Fatmira	Jahja (Berisha)	Enkelona	Guza
Ariana	Dhimitri (Lako)	Marsela	Ziu (Velo)	Marsida	Laho	Ariana	Dhimitri (Lako)	Iris	Ahmetaj	Aurora	Napuçe	Aurora	Napuçe	Enkelona	Guza	Aurora	Napuçe	Enkelona	Guza	Ariana	Dhimitri (Lako)	Enkelona	Guza
Besa	Rustemi	Florjana	Rustemi	Oljona	Saica	Besa	Rustemi	Enejda	Yzeiri	Adriana	Alika	Adriana	Alika	Enkelona	Guza	Adriana	Alika	Enkelona	Guza	Besa	Rustemi	Enkelona	Guza
Josif	Risto	Florjana	Rustemi	Florjan	Pilafti	Josif	Risto	Vabona	Shahu	Arjana	Bajraktari	Arjana	Bajraktari	Enkelona	Guza	Arjana	Bajraktari	Enkelona	Guza	Josif	Risto	Enkelona	Guza
Miranda	Risto	Lorina	Mihali	Milvina	Hasani	Miranda	Risto	Besnike	Bulku	Arba	Dyrmishi	Arba	Dyrmishi	Enkelona	Guza	Arba	Dyrmishi	Enkelona	Guza	Miranda	Risto	Enkelona	Guza
Mimoza	Jano (Daka)	Florjan	Risilja	Besnike	Bulku	Mimoza	Jano (Daka)	Paola	Shehu	Alketa	Berdalli	Alketa	Berdalli	Enkelona	Guza	Alketa	Berdalli	Enkelona	Guza	Mimoza	Jano (Daka)	Enkelona	Guza
Juliana	Dodibiba (Leka)	Ana	Sahatciu	Paola	Shehu	Juliana	Dodibiba (Leka)	Entela	Kapaj	Aleksandra	Gjoni	Aleksandra	Gjoni	Enkelona	Guza	Aleksandra	Gjoni	Enkelona	Guza	Juliana	Dodibiba (Leka)	Enkelona	Guza
Adelina	Hysi (Loloci)	Terezina	Curri	Eglantina	Mustafaj	Adelina	Hysi (Loloci)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Adelina	Hysi (Loloci)	Enkelona	Guza
Franga	Marku (Kerthi)	Arta	Balliu	Geraldina	Myftari	Franga	Marku (Kerthi)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Franga	Marku (Kerthi)	Enkelona	Guza
Vladimir	Memishahi	Ina	Rapaj	Lirida	Kreste (Xhepa)	Vladimir	Memishahi	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Vladimir	Memishahi	Enkelona	Guza
Dragush	Kurti	Erinda	Braho (Pepe)	Shpendi	Husi	Dragush	Kurti	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Dragush	Kurti	Enkelona	Guza
Inis	Aliaj (Kadiu)	Agim	Lami	Doarta	Mulgeci	Inis	Aliaj (Kadiu)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Inis	Aliaj (Kadiu)	Enkelona	Guza
Mira	Durrësi (Santo)	Olivera	Husi	Arjela	Hazisi	Mira	Durrësi (Santo)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Mira	Durrësi (Santo)	Enkelona	Guza
Vjollca	Koço (Taja)	Eriona	Xhelili	Arjela	Hazisi	Vjollca	Koço (Taja)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Vjollca	Koço (Taja)	Enkelona	Guza
Mirinda	Berisha	Albano	Gjoci	Odeta	Banushaj	Mirinda	Berisha	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Mirinda	Berisha	Enkelona	Guza
Entela	Fusha	Majlinda	Muja	Lorela	Gjysh	Entela	Fusha	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Entela	Fusha	Enkelona	Guza
Anila	Lilo	Esmeralda	Kaçi	Anastasi	Gjoka	Anila	Lilo	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Anila	Lilo	Enkelona	Guza
Nazmie	Kocibellin (Subashi)	Marsida	Hysa	Marina	Bazi	Nazmie	Kocibellin (Subashi)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Nazmie	Kocibellin (Subashi)	Enkelona	Guza
Lulzime	Shehu	Adelina	Sinamati	Arjola	Tola	Lulzime	Shehu	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Lulzime	Shehu	Enkelona	Guza
Diana	Hazizaj (Mema)	Egla	Bakullari	Anida	Laraku	Diana	Hazizaj (Mema)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Diana	Hazizaj (Mema)	Enkelona	Guza
Gazmend	Aliaj	Ingjida	Dine	Kozeta	Xhani	Gazmend	Aliaj	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Gazmend	Aliaj	Enkelona	Guza
Suela	Zeneli (Kuci)	Redi	Kordhishti	Lumturi	Bano	Suela	Zeneli (Kuci)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Suela	Zeneli (Kuci)	Enkelona	Guza
Vjola	Liçanji	Alketa	Xhelili	Lindjela	Kapaj	Vjola	Liçanji	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Vjola	Liçanji	Enkelona	Guza
Ardi	Dervishi	Klarita	Karriçi	Luljeta	Leka	Ardi	Dervishi	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Ardi	Dervishi	Enkelona	Guza
Vitori	Bajrami (Majko)	Daniela	Ngjerci	Laureta	Gjini	Vitori	Bajrami (Majko)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Vitori	Bajrami (Majko)	Enkelona	Guza
Luan	Lekli	Natasha	Xeka	Leonora	Vadajri	Luan	Lekli	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Luan	Lekli	Enkelona	Guza
Simon	Rada	Alban	Mosho	Lida	Dedaj	Simon	Rada	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Simon	Rada	Enkelona	Guza
Valbona	Selita (Doda)	Dritan	Hoxha	Liljana	Lena	Valbona	Selita (Doda)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Valbona	Selita (Doda)	Enkelona	Guza
Feride	Hasa (Duka)	Ursola	Merkuri	Kozeta	Xhani	Feride	Hasa (Duka)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Feride	Hasa (Duka)	Enkelona	Guza
Elmije	Muho	Julinda	Veli	Lumturi	Bano	Elmije	Muho	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Elmije	Muho	Enkelona	Guza
Fullanxa	Trokitri (Dedaj)	Alba	Joca	Lindjela	Kapaj	Fullanxa	Trokitri (Dedaj)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Fullanxa	Trokitri (Dedaj)	Enkelona	Guza
Anisa	Rafti	Edena	Keçi	Luljeta	Leka	Anisa	Rafti	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Anisa	Rafti	Enkelona	Guza
Vjollca	Mandili (Harapi)	Erisa	Petro	Laureta	Gjini	Vjollca	Mandili (Harapi)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Vjollca	Mandili (Harapi)	Enkelona	Guza
Danjela	Bejleri (Cekani)	Zhaneta	Didi	Leonora	Vadajri	Danjela	Bejleri (Cekani)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Danjela	Bejleri (Cekani)	Enkelona	Guza
Dashuri	Kashi (Kucani)	Ledio	Orozi	Lida	Dedaj	Dashuri	Kashi (Kucani)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Dashuri	Kashi (Kucani)	Enkelona	Guza
Harta	Vezeaj (Zaimi)	Elisa	Marga	Liljana	Lena	Harta	Vezeaj (Zaimi)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Harta	Vezeaj (Zaimi)	Enkelona	Guza
Vojsava	Papamihali (Pajenga)	Engerta	Cami	Luftarake	Shuteriqi	Vojsava	Papamihali (Pajenga)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Vojsava	Papamihali (Pajenga)	Enkelona	Guza
Alketa	Rapia (Nelku)	Elira	Mustafaraj	Mimoza	Kadillari	Alketa	Rapia (Nelku)	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Enkelona	Guza	Alketa	Rapia (Nelku)	Enkelona	Guza
Raimonda	Vangjeli	Elira	Mustafaraj	Mimoza	Kadillari	Raim																	

Minimali

Pensioni minimal do të rritet me 580 lekë të reja. Kjo do të thotë që nga 14 500 lekë që është sot, pensioni minimal në 2016-n do të jetë 15 mijë lekë të reja për të moshuarit

Cilat pensione do rriten me 4% duke filluar nga 2016-a

Përfitojnë të gjithë pensionistët, rriten të ardhurat minimale e kompensimet



DRIÇIM ÇAKA TIRANE

Rritja e pensioneve me 4%, për vitin 2016-t do të prek të gjitha kategoritë, duke filluar nga ata që marrin pension pleqërie deri te minororët apo shtetas mujore të invalidëve. Burime nga Ministria e Mirëqenies Sociale bëjnë me dije se rritja edhe për vitin e ardhshëm, e parashikuar në buxhet do të bëhet për të njëjtat kategori, që u bë edhe indeksimi në muajin korrik.

PENSIONET

Ndryshe nga dy vitet e kaluara qeveria ka parashikuar që për vitin 2016 pensionet të rriten me 4%. Kjo do të thotë se një pensionistë do të përfitojë nga 400 deri në 1200 lekë të reja shtesë, duke filluar nga viti i ardhshëm. Qeveria "Rama" në dy vitet e fundit i ka rritur pensionet me 2% në vitin 2014 dhe me 1.6% në vitin 2015.

RRITJA

Në buxhetin e ri i cili pritet të dorëzohet në Kuvend në fund të këtij muaji, parashi-

kohet se rritja e pensioneve do të bëhet brenda 6 muajve të parë të 2016-s. Fondi për rritjen do të jetet Institutit të Sigurimeve Shoqërore, jo nga buxheti i shtetit, por nga rritja e numrit të kontribuuesve, që sot janë në raportin 1 përfitues, për 1.2 kontribuues.

KATEGORITË

Por cilat do të jenë kategoritë që do të rritet pensioni vitin e ardhshëm? Pensionet e

RRITJA

Në buxhetin e ri i cili pritet të dorëzohet në Kuvend në fund të këtij muaji, parashikohet se rritja e pensioneve do të bëhet brenda 6 muajve të parë të 2016-s. Fondi për rritjen do të jetet ISSH

plota të pleqërisë, pensionet e plota të invaliditetit dhe pensionet e plota familjare dhe pensionet e parakohshme.

PENSIONET E POSAÇME SHTETËRORE.

Shtesa mujore, e përfutur me vendimin nr.326, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtesve nazifashistë të popullit shqiptar". Pensioneve

SHIFRAT

Sa rriten pensionet dhe të ardhurat minimale



Pensioni minimal do të rritet me 580 lekë të reja. Kjo do të thotë që nga 14 500 lekë që është sot, pensioni minimal në 2016-n do të jetë 15 mijë lekë të reja. Të ardhurat minimale do të rriten 370 lekë dhe nga 9400 lekë që janë sot, do të shkojnë në 9470 lekë. Rritja do të përfshijë edhe kompensimet që janë përfutur gjatë viteve nga të gjithë pensionistët. Më shumë do të rriten pensionet e larta. Kështu një pension prej 20 mijë lekësh do të rritet me 800 lekë, ndërsa një pension prej 25 mijë lekësh do të rritet me 1000 lekë të reja. Sipas parashikimeve do të rriten edhe pensioni social për ata të moshuar që e kanë përfutur gjatë 2015-s, i cili është në masën 6750 lekë. Për pensionet mesatare prej 18 mijë lekë rritja do të jetë 720 lekë të reja. Pra nga 18 mijë do të përfitohet 18 720 lekë në vitin 2016-t. Prje disa vitesh pensionet nuk janë rritur më shumë se 2%.

e caktuara me dekretin nr.758, datë 1.2.1994, të Presidentit të Republikës, "Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut". Pensioneve të caktuara dhe të rillogaritura me ligjin nr.10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakeve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë

dhe nr.7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Pensionet e pleqërisë të punonjësve të minierave në nëntokë, të caktuara me ligjin nr.150/2014, datë 6.11.2014, "Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë". Pensionet suplementare të caktuara sipas ligjit nr.8097, datë 21.3.1996, "Për pensionet shtetërore

suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", të ndryshuar. Pensionet suplementare të caktuara sipas ligjit nr.10139, datë 15.5.2009, "Për pensionet shtetërore suplementare të pu-

SHTESA

Ndryshe nga dy vitet e kaluara qeveria ka parashikuar që për vitin 2016 pensionet të rriten me 4%. Kjo do të thotë se një pensionistë do të përfitojë nga 400 deri në 1200 lekë të reja shtesë, duke filluar nga 2016

së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit dhe punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Pensionet e caktuara sipas ligjeve nr.4171, datë 13.9.1966, "Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë", nr.4976, datë 29.6.1972, "Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë",

nonjësve të universiteteve, të shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë. Trajtimeve e veçanta financiare të familjeve të pilotëve futurues. Të gjitha kompensimet për të ardhurat mujore të gjitha të ardhurat minimale për pensionistë

PRECEDENTI

Ligji për arsimin e lartë, në protestë edhe studentët e Durrësit



Studentët të universitetit publik të Durrësit u janë bashkuar protestave të studentëve të Tiranës, kundër reformës së arsimit të lartë. Studentët e universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës kundërshtuan mënyrën si do bëhet financimi, duke u shprehur se vihet shenja e barazimit mes Universitetit Publik dhe atij privat dhe rriten tarifat e studimit. Ata paralajmëruan përshkallëzim protestash, në rast se nuk rishihet ligji për arsimin e lartë.

INFORMALITETI

Rritet numri i bizneseve të regjistruara në Qarkun e Fierit



Aksioni ndaj informalitetit në qarkun e Fierit, ka sjellë rritje të numrit të bizneseve të regjistruara. Sipas të dhënave nga drejtoria rajonale e Tatimeve, për periudhën dy mujore (që prej njesjes së aksionit kundër informalitetit) numërohen 2200 biznese më shumë të regjistruara, ndërsa ka rreth 5 mijë aplikime të fermerëve për t'u formalizuar. "300 fermerë në javë të zonës së Lushnjës dhe 200 fermerë të zonës së Fierit", thanë burime pranë drejtorisë rajonale të Tatimeve.

VARFERIA

Romët e egjiptianët, shumë pengesa në përfshirjen sociale

Romët e egjiptianët hasin pengesa të shumta si varfëria, niveli i arsimit, shëndetësia, punësimi dhe pengesa institucionale që ndikojnë në përjashtimin social. Ky ishte konkluzioni i një studimi bazuar në 34 intervista të kryera me anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian. Studimi u prezantua djë në një aktivitet, ku morre pjesë edhe zv/ministria e Mirëqenies Sociale, Bardhylka Kospiri.

Diabeti, në Shqipëri vuajnë 150 mijë persona

Ministri Ilir Beqaj: 12,5% e moshave 40-65 vjeç që kanë bërë kontrollin, janë paradiabetikë

DRIÇIM ÇAKA
TIRANË

ILIR BEQAJ

Në Shqipëri rreth 150 mijë persona vuajnë nga diabeti. Të dhënat e kontrollit shëndetësor bazë për moshat 40-65 kanë zbuluar se diabeti është një nga sëmundjet më të përhapura në vendin tonë. Në konferencën “Aksesi universal në shërbime dhe mjekësia e familjes, Sëmundjet kronike në fokus”, Ministri i Shëndetësisë Ilir Beqaj u shpreh se nga kontrolli falas, është zbuluar një numër i lartë personash që vuajnë nga sëmundjet të cilat nuk kishin informacion. “4% e personave që kanë bërë kontrollin rezultojnë me diabet dhe nuk e dinë. Nëse ky 4% ka dalë nga grupmosha 40-65 vjeç, do të thotë që është dhe më e madhe përqindja e personave në Shqipëri që janë me diabet dhe nuk e dinë që janë me diabet. Ndërkohë, 12,5% e personave që kanë bërë kontrollin, vlerësohen si paradiabetikë. Rreth 18% nuk e dinë që janë me hipertension. Na rezultojnë gjithashtu, se 35% e njerëzve e dinë që janë me hipertension, por në ditën e kontrollit të kanë rezultuar prapë në gjendjen e kësaj sëmundje, që do të thotë që është dhe më e madhe përqindja e personave në Shqipëri që janë me diabet dhe nuk e dinë që janë me diabet”, - u shpreh Beqaj.

SËMUNDJET

Pjesa më e madhe grupmoshave 40-65 vjeç vuajnë nga më shumë se një sëmundje. “Nga të sëmurët që kemi ne

“Duhet të bëjmë më të ndjeshëm burrat që të kontrollohen”

Sipas Ilir Beqajt duhet të bëhet më shumë që edhe burrat të përfshihen në programin e kontrollit. “Na duhet të punojmë për programe më të shënjestruara sensibilizimi, që do të thotë, duhet të bëjmë më të ndjeshëm burrat për të marrë pjesë në program, dhe duhet të bëjmë më të ndjeshëm grupmoshën 40-50 vjeç. Por ndërkohë, besoj se na duhet të punojmë në gjykimin tim, për të rikonceptuar të gjithë kujdesin shëndetësor parësor, të paktën për dy gjëra: (a) Sëmundjet që flasin janë sëmundje shumë të përhapura, dhe padyshim nuk mund t’ia dalim vetëm me shërbimet universitare”, - theksoi Beqaj.

sot të diagnostikuar me diabet, vëmë re se 30% e pacientëve me sëmundje të syrit, janë diabetikë. 30% e atyre që kanë sëmundje të veshkës dhe që bëjnë hemodializë, janë diabetikë. 30% e atyre që vuajnë nga hipertensioni, janë diabetikë,

që do të thotë, kemi tashmë në rastet e këtyre sëmundjeve, disa sëmundje kronike bashkë”, - theksoi Beqaj. Sipas Ministrisë të Shëndetësisë shpenzimet mesatare vjetore vetëm për barnat e rimbursueshme të të sëmurëve me diabet, janë rreth 30 mijë lekë në vit, ndërkohë që një kontroll bazë, kushton me gjithë tatimin mbi vlerën e shtuar 1845 lekë. Falë kontrollit falas për grupmoshat 40-65 vjeç është bërë e mundur gjithashtu që të ulët edhe kostoja e këtyre sëmundjeve, kryesisht diabetit. “Do të thotë që e zbulojmë hershëm dhe përqipimi ta shtyjmë, - pra, ai 30 mijë lekësh do të kursehet, por edhe sëmundja e syve, sëmundja e veshkave, hipertensionin, që kanë edhe ato koston e vetë ekonomike dhe sociale, do t’i shtyjmë në kohë”, - përmendi Ministri i Shëndetësisë.

PLANI

Sipas Beqajt duhet të shtohet mundësia që mjekët e familjes, të punojnë sa më të pavarur me rezultatet e kontrollit për qytetarët që ata trajtojnë. “Brenda pranverës së ardhshme, do ta ofrojmë për çdo mjek në kujdesin shëndetësor parësor, sepse Fondi (FSDKSH) brenda vitit, do të jetë në gjendje t’i ofrojë çdo mjeku një kompjuter portatabel, një printer dhe një lidhje Interneti për nevojat të recetës elektronike, por tashmë që do t’i kemi këto pajisje, keni aksesin tuaj në Internet, të mos ju duhet të shkoni ta bëni me kohë pritjeje, me grafik, tek kabiniti i Check-Up-it, por ta bëni gjithsecili në zyrën tuaj”, - u shpreh Beqaj.



Gjatë konferencës së djeshme



Ministri i Shëndetësisë Ilir Beqaj

SËMUNDJA

4% e personave që kanë bërë kontrollin rezultojnë me diabet dhe nuk e dinë. Dhe nëse ky 4% ka dalë nga grupmosha 40-65 vjeç, do të thotë që është dhe më e madhe përqindja e personave në Shqipëri që janë me diabet dhe nuk e dinë që janë me diabet

LAJME SHKURT



**Shkodër, bojkotohet mësimi:
Duam gjuhën angleze, jo franceze**

Pasi kanë zhvilluar prej 3 muajsh mësimin në gjuhën angleze, këtë javë, nxënësit e klasës së tretë të shkollës “Mati Logoreci” në Shkodër, do të nisnin mësimin në gjuhën frënge. Kjo ishte arsyeja që prindërit e nxënësve kanë dalën në protestë paraditen e djeshme. Shefi i burimeve njerëzore të Drejtorisë Rajonale Arsimore, Edvin Rexhepi, tha se ky është një projekt i MAS në bashkëpunim me me Aleancën Franceze. Ndërsa, prindërit thanë se kjo bie në kundërshtim edhe me rregulloren e arsimit e cila thotë se deri në klasë të 6-të nuk mund të hyjë asnjë gjuhë e dytë përveçse asaj të anglishtes.



**Nënkryetari i Bashkisë Mazniku:
Fund përmbytjeve te “Don Bosko”**

Nënkryetari i Bashkisë Tiranë, Arban Mazniku, prezantoi dje projektbuxhetin e vitit 2016 në njësinë nr.9. Mazniku tha se ndërhyrjet në kanalizimin e ujërave të zeza në rrugën “Don Bosko” si dhe rehabilitimi i trotuaeve, do të lehtësojë jetën e qytetarëve në këtë lagje të kryeqytetit. Ai shtoi se me ardhjen e shirave, banorët e njësisë 9 nuk do të përballen me torturat që sjellin kanalizimet e bëra jashtë çdo lloj standarde, që çdo vit e përmbysin këtë zonë. Nënkryetari i Bashkisë së kryeqytetit bëri me dije se me buxhetin e vitit 2016 do të vendoset shërbim urban në rrugën “Jordan Misja”.

AKU nis kontrollin për mishin: S’ka më sallam pa markë

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit nisi dje kontrollin e mishit në të gjitha subjektet tregtare në Bashkinë e Elbasanit. Drejtori i Përgjithshëm i AKU-së, Afrim Bakaj tha se do të kontrollohen rreth 74 subjekte që tregtojnë mish. Sipas tij, qëllimi i këtij aksioni është pajisja me certifikatë të origjinës dhe sigurisë për të gjitha nënproduktet e mishit që tregtohen. Ai shtoi se aksioni do të shtrihet në nivel kombëtar. “Nuk do të lejohet tregtimi i sallamit pa markë. Do të kontrollohet niveli i fosfatëve në bazë të kushteve të OBSH-së”, tha drejtori i AKU-së.



Aksioni kundër informalitetit, tregtarët në protestë

Tregtarët e tregut industrial në kryeqytet dhe ata të “tregut çam”, protestuan paraditen e djeshme ndaj aksionit të qeverisë në luftën kundër informalitetit. Ata thanë se nuk i përballonin dot gjokat e larta ndëshkuese dhe shprehen se po trajtohen më keq se në diktaturë. Ligji i ri për “Procedurat tatimore” hyn në fuqi më 12 Nëntor. Ky ligj përfshin gjoba nga 500 mijë lekë të reja deri në 1 milionë. Tregtarët paralajmëruan një tjetër protestë para kryeministrisë, në orën 09:00 të ditës së premtë për të kundërshtuar sanksionet. Ata bënë thirrje se “nuk do të dorëzohen para qeverisë”.

Mjedisi, MM takim me institucionet shtetërore

Ministria e Mjedisit zhvilloi dje një takim me institucionet shtetërore lidhur me zbatimin dhe aplikimin e Ligjit “Për Lejet e Mjedisit” dhe ligjit “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis (VNM)”. Në takim, morën pjesë përfaqësuesit e Agjencive Rajonale të Mjedisit, përfaqësuesit nga Bashkitë e vendit, përfaqësuesit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, si dhe nga Qendra Kombëtare e Licencimit. Drejtori i Përgjithshëm i Politikave të Mjedisit, Pëllumb Abeshi, e konsideroi mjaft të rëndësishëm takimin e inicuar nga Ministria e Mjedisit.



**Vlorë, AKU:
Biznesi i madh, i regjistruar si i vogël**

Bizneset e mëdha në qytetin e Vlorës, në masë të konsiderueshme rezultojnë të regjistruara si biznese të vogla duke fshehur kështu të ardhura. Kështu është shprehur për mediat kreu rajonal i Autoritetit të Kontrollit Ushqimor Renato Banushi, pjesë e task-forcës ndaj informalitetit. “Do fokusohemi kryesisht te disa fast foodet që janë në qytetin e Vlorës që në pamje të parë janë biznese të mëdha dhe operojnë si biznese të vogla”, tha Banushi. Ai shtoi se në informalitet kanë punuar edhe fabrikat e prodhimit të vajit të ullirit dhe kantinat e verës.

Sms prokurores, të gjeta në rrugë të bëj për karrocë

Zbardhe SMS-të e kanosjes nga Anglia të Prokurores Oltiana Çifligu. Kërcënon dhe gjyqtaren

ELTON QYNO
TIRANE

Ngritja e akuzës për "Dhunë në familje", ndaj shtetasit Alban Beshiri, ka sjellë kërcënimin me jetë të prokurores së Durrësit Oltiana Çifligu. Pas dërgimit si të pandehur të 33-vjeçarit në gjykatën e Durrësit, prokuroria është përballur me një sërë kërcënimesh në telefon dhe sms, nga shtetasi Alban Beshiri. Ky i fundit kërcënon-te nga Anglia se do të kthehej në Shqipëri dhe do i bënte diçka që nuk kishte spital që ta merrte në dorëzim. "...Do të kapi e zeza ty dhe atë gjyqtaren qorre që ma vlerësoi vajzën 5 mijë euro. Me ty e kam më kollaj pasi ta di shtëpinë dhe të njoh të dashurin, dhe do të bëj për karrocë..." - ka kërcënuar Beshiri prokuroren e Durrësit. Nisur nga kjo situatë prokuroria Çifligu i është drejtuar me një kallëzim prokurorisë e cila ka marrë të pandehur shtetasin Alban Beshiri, duke e akuzuar atë për veprën penale të "Kanosjes së gjyqtarit".

KALLËZIMI

Nisur nga kjo situatë prokuroria Çifligu i është drejtuar me një kallëzim prokurorisë e cila ka marrë të pandehur shtetasin Alban Beshiri, duke e akuzuar atë për veprën penale të "Kanosjes së gjyqtarit".

gjykatës gjithë veprimtarinë e saj si prokurore, me atributin e përfaqësimit të akuzës dhe ushtrimit të ndjekjes penale ndaj të pandehurit Alban Beshiri për procedimin penal në përfundim të të cilit është dënua me vendim gjyqësor të formës së prerë dhe mënyrën se si ai ishte sjellë e kishte vepruar në rrugë telefonike ndaj saj, pas vendimit të fajësisë të dhënë nga ana e gjykatës. Çifligu ka deklaruar përpara gjykatës për gjendjen e vështirë psikologjike që i ishte krijuar nga telefonatat dhe "sms"-të kërcënuese që i pandehuri kishte drejtuar ndaj saj. Konkretisht dëshmitarja ndër



Gjykatë e Tiranës

të tjera ka dëshmuar se: "... më datë 18.07.2014, ditën e Premte rreth orës 06:06 të pas ditës ka marrë një mesazh telefonik nga numri i telefonit +447557883XXX i cili është prezantuar si shtetasi Alban Beshiri dhe ka trajtuar problematikën duke aluduar dhe duke bërë presion për pub-

likimin mediatik të rastit në Angli dhe duke kërcënuar me afate, për përgjigje. Shqetësimi ka vijuar përgjatë gjithë ditës të datës 18.07.2014 me thirrje telefonike dhe sms. Gjithashtu, më datë 21.07.2014 nga po i njëjti numër +447557883XXX ka vijuar me mesazhe

TELEFONATA

Ditën e premte rreth orës 06:06 të pas ditës ka marrë një mesazh telefonik nga numri i telefonit +447557883XXX i cili është prezantuar si shtetasi Alban Beshiri dhe ka trajtuar problematikën duke aluduar.

kërcënuese të vazhdueshme ndaj saj në oraret 11.26, 01.45; 03.02; 03.29 dhe për gjatë gjithë ditës ky numër e ka telefonuar vazhdimisht.

KANOSJA ME MESAZHE

Ndërsa në orën 23:44 të darkës të datës 21.07.2014 nga një numër tjetër në dukje Anglez konkretisht +447707238XXX i është dërguar një mesazh tjetër kërcënues me përmbajtjen: "...Oltijana Çifliku un i mbarova ato që kisha me bo tani nigjo mir këtë që po të them po të kapa në rrug nuk do të mari spital për sipër këtë e ke të sigurt që do të lej në karrocë. Ty të kap rehat se

ta di shtëpinë në Durrës dhe atij të dashurit tat ja di kështu që me ty e kam rehat kurse asaj qorres që më vlerësoj gocën 5000 Euro asaj kam një dhuratë të mir dhe për atë dhe për familjen e asaj ishalla e punojnë brezin kufitar që të më gjejnë gjurmët se po u futu në Shqipëri të kapi e zeza ty me gjyqtarën. Good look..."

MESAZH PËR MUSTAQE MIUN

Ndërsa më datë 18.08.2014 rreth orës 10.06 të darkës nga numri +447557883XXX i është dërguar një sms me tekst në Anglisht ku aludohet se është një vajzë me emrin Jade e dashura e shtetasit Alban Beshiri sipas përmbajtjes së mesazhit e cila i kërkon që ta telefonoj pasi Albani ka dalë jashtë nga shtëpia. Mesazhet kërcënuese kanë vijuar nga numër +447707238XXX edhe më datë 05.01.2015 dhe konkretisht me përmbajtjen "...Na fal për shqetësimin që po të besdis por doja t'ju çojë i mesazh atyre të prokuroria me kujto se ky syri im s'ka peshë ty të kam fal për gjithë letrat që mi bone me ato që i di vet ti dhe ta kam premtu që s'do ta përmend mo, por ato policat e kombinatit që me lan qorr jo deri sa të marr frymë por edhe atyre që më lan 5 ditë të më rrifnin dhe ato do ti kapi dallga do ta çojmë deri në fund kët gj dhe atë mustaqe miun që mbiron policat joja këtë mesazh nëse ke mundësi dhe gjen nai histori të bukur për veten që ti shpëtosh dallgës..."

TELEFONATAT KËRCËNUESE

Në gjykim ka dhënë dëshminë e saj shtetasja Oltiana Çifliku, e cila ka shpjeguar në mënyrë të hollësishme dhe kronologjike përpara

LAJME SHKURT



Protesta për ligjin e Arsimit të Lartë, hakohet faqja e MAS

Faqja online e Ministrisë së Arsimit është sulmuar dje nga "RedAnons.AL". Në mesazhin e publikuar në faqen e MAS, bëhet thirrje për pjesëmarrje në protestën që pritet të zhvillohet sot në orën 11:00 para Kryeministrisë. "Ne si RedAnons.AL ftojme të gjithë ata gjimnazistë që janë të pjekur e që mbajnë veten si lider të ardhshëm e që shqetësohen me të vërtetë për të ardhmen e tyre dhe të këtij vendi. Po luhet me të ardhmen tonë dhe të ardhmen e fëmijëve tuaj. Mjaft qëndruam duarkryq, mjaft heshtëm. Po na tallin, po na zhvatën", thuhet në mesazh.

Shkarkohet drejtori i spitalit nga LSI, i riu emërohet nga PS

Drejtori i spitalit rajonal të Gjirokastrës, Armand Mamani, njëkohësisht edhe kryetar i LSI-së, është shkarkuar nga detyra. Burime bëjnë me dije se ka qenë një kontroll i ushtruar nga Ministria e Shëndetësisë, pas disa akuzave për abuzime me detyrën nga kreu i spitalit rajonal, që kanë çuar Ministrin e Shëndetësisë, Ilir Beqaj, të ndërmarrë këtë masë. Po kështu, mësohet se me një shkresë të mbërritur në spital, drejtor i ri është komanduar Roland Karalli, mjek kirurg, aktualisht kryetar i këshillit bashkiak të Gjirokastrës, dhe përfaqësues i PS-së.

Sherr mes tre shqiptarëve në Zvicër, policia plagos njërin

Një shqiptar ka mbetur i plagosur pas disa të shtënave nga ana e policisë zvicerane. Ngjarja ndodhi mbrëmjen e djeshme në provincën Waadlander. Sipas mediave zvicerane, në pranga kanë përfunduar edhe dy shqiptarë të tjerë. Raportohet se dy shqiptarë po kërcënonin me vdekje të tretin dhe nuk i bindën efektiveve të policisë për t'u ndarë paqësisht, madje sulmuam këta të fundit.



Njëri nga ata qëlloi me shufër hekur i një punonjësi policie, përpara se forcat e rendit të përdornin armët e zjarrit. I plagosuri u dërgua në spital dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën, raporton suedostschéeiz.ch.



9 mujori, bankat rrisin investimet jashtë me 207 milionë euro

Totali i aktiveve të sistemit bankar arriti në 1.32 trilionë lekë në fund të 9 mujorit të këtij viti, duke shënuar një rritje me 2.4%, apo me 31 miliardë lekë, në krahasim me dhjetorin 2014, sipas statistikave të publikuara nga Banka e Shqipërisë. Në 9 muajt e këtij viti, forma e investimit që ka dominuar në sistemin bankar ka qenë ajo e vendosjes së parave jashtë vendit, si "depozita në banka, institucione krediti dhe institucione të tjera financiare". Ky zë është zgjeruar ndjeshëm me 16.4% apo me 30 miliardë lekë në vlerë absolute (207 milionë euro), në raport me fundin e 2014-s, duke ndikuar në 100% të rritjes së totalit të aktiveve.

Tiranë, makina përplaset me bordurën, humb jetën drejtuesi



Një person ka mbetur i vdekur dhe një tjetër është plagosur mbrëmjen e djeshme në Mullet të Tiranës. Mësohet se një automjet me targa AA 217 AT, është përplasur me një bordurë. Për pasojë, drejtuesi i automjetit i identifikuar me inicialet A.T., ka mbetur i vdekur, ndërsa një tjetër shtetas që ndodhej brenda automjetit ka mbetur i plagosur. Ky i fundit, identiteti i të cilit nuk bëhet i ditur, është dërguar në spital dhe mësohet se është në gjendje të rëndë. Forcat e policisë punojnë për zbardhjen e shkaqeve të aksidentit.

Tiranë, i përndjekuri majë vinçit, zbret pas një ore

Një ish i përndjekur politik vuri dje në alarm policinë e kryeqytetit, pasi për një orë qëndroi në majë të një vinçi, në një lartësi të konsiderueshme. Xhemal Zhuri bënte vazhdimisht veprime që cënonin sigurinë e tij teksa qëndronte majë vinçit, që ndodhej në një pallat në ndërtim e sipër

pranë Gjykatës së Lartë. Policia rrethoi zonën ndërsa disa efektive u ngritën në katet e larta të pallatit për të negociuar me Zhurin. Pas një ore mbi vinç, ish i përndjekuri vendosi të zbresë pa ndihmë e policisë. Edhe në vitin 2012 ish i përndjekuri ka tentuar të hidhet nga një vinç.

Akuza burg përjetë për Mjacaj ekzekutoi dy turistët nga Çekia

Sokol Mjacaj vrau me dashje dy turistët e huaj në Dukagjin

Burg përjetë kërkoi prokuroria e Shkodrës për Sokol Mjacaj, të riun i cili vrau dy turistë çekë në Dukagjin. Prokuroria i ka kërkuar trupit gjyqes të deklarojë fajtor Sokol Mjacaj, ndërkohë avokatja mbrojtëse Elvira Jakova i ka kërkuar organit të akuzës disa ditë kohë për përgatitjen

përfundimtare të konkluzioneve. Kërkesë kjo e miratuar nga trupi gjyqes i cili shtyu seancën në ngarkim të Mjacajt për në 16 nëntor. Në konkluzionet përfundimtare, prokuroria e çështjes Shqiponja Milla ka deklaruar se Sokol Mjacaj ka ekzekutuar me dashje çiftin çek. Fillimisht ka qëlluar mbi Michael Svatos dhe më pas në të njëjtin pozicion ekzekutimi Mjacaj sipas prokurorisë nga prapa ka qëlluar edhe mbi Anna Kosinovën. Për shkak të këtij krimi dhe në bashkim të dënimeve të "vjedhjes me pasojë vdekjen" dhe "armëmbajtjes pa leje", organi i akuzës ka kërkuar burgim të përjetshëm për Mjacaj. Sakaq në seancën e një jave më parë më 3 nëntor, Mjacaj kërkoi mëshirë

para trupit gjyqes, ndërkohë që tha se ditën kur kreu krimin ai kishte dalë për të bërë grabitje dhe jo për të vrarë njeri. Sipas tij ai e vrau Michael Svatos nga frika se mos ai i rrëbente armën dhe do qëllonte ndaj tij, ndërsa Anna Kosinovën e ka qëlluar aksidentalisht dhe pa dashje. Më herët në seancën e zhvilluar më 29 tetor, Mjacaj iu rrëzua kërkesa për gjykim të shkurtuar. Sokol Mjacaj ekzekutoi në korrik të 2015-ës në Prekal të Dukagjinit 2 turistët çek Michael Svatos dhe të dashurën e tij Anna Kosinova pasi tentoi t'i grabiste. Mjacaj u arrestua pak ditë pas krimit në fshatin e Grudës ndërsa me 16 Nëntor pret vendimin nga Gjykata e Shkallës së Parë në Shkodër.



Sokol Mjacaj

NË 2 KORRIK

Sokol Mjacaj ekzekutoi në korrik të 2015-ës në Prekal të Dukagjinit 2 turistët çek Michael Svatos dhe të dashurën e tij Anna Kosinova pasi tentoi t'i grabiste.

LAJME shkurt

Shkodër, pranga 15 vjeçarit, vjedh lokalit

Një 15 vjeçar është arrestuar nga policia, pasi akuzohet për vjedhje të një biznesi tip lokal, në Shkodër. Mësohet se në pranga ka rënë 15 vjeçari E.H., banues në fshatin Dobrac. I arrestuar dy ditë më parë, i mituri dyshohet se ka vjedhur materiale me vlerë 50 mijë lekë të reja në lokalit e 35 vjeçarit N. M., banues në fshatin Gruda Re, Shkodër. Ndaj të ndaluarit vijojnë ende hetimet, për të zbuluar raste të tjera vjedhjesh ku mund të jetë përfshirë.



Kavajë, makina përplas 48 vjeçaren

Një 48 vjeçare ka ndërruar jetë pas një aksidenti rrugor të ndodhur gjatë ditës së djeshme në Kavajë. Mësohet se viktimë ka mbetur 48 vjeçarja V.K., banuese në fshatin Synej, Kavajë. Ajo ka ndërruar jetë si pasojë e plagëve të marra pasi është përplasur nga një automjetit me targa AA096 ML. Sipas policisë, viktimë ishte duke ecur në këmbë, kur është goditur nga automjeti. Efektivët e policisë, të cilët shkuan në vendngjarje, bënë të mundur ndalimin e drejtuesit të automjetit Stefano Franceskini.

Plagosje në Shkodër, Rama në kërkim

Një person ka mbetur i plagosur në Shkodër paraditen e djeshme. Mësohet se rreth orës 10.50, Elfit Rama ka goditur me thikë 39-vjeçarin A.M. Ngjarja ka ndodhur në lagjen "Partizani", ku banonin edhe dy personat. Burime zyrtare nga policia thanë se gjithçka ka ndodhur pas një konfliktit të çastit. I plagosuri u dërgua në spitalin e Shkodrës dhe mësohet se ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Ndërsa, Rama është shpallur në kërkim.

"Pulëbardha", Xhoana Nano padit në gjykatë bashkinë

Gruaja e ish-kryeministrit Nano kundërshton Veliaj

ELTON QYNO
TIRANË

Deklarata
Erion Veliaj, paralajmëroi largimin e "Pulëbardhës"



Paralajmërimin e parë për largimin e restorantit "Pulëbardha" e ka dhënë kryebashkiaku i Tiranës Erjon Veliaj. Ky i fundit në një takim me temë sportin, ka kërkuar që stadiumi i klubit sportiv Tirana, është në fazën e rikonstruksionit dhe se të gjitha ambientet e këtij stadiumi do jenë pjesë dhe në shërbim të sportistëve dhe jo të bizneseve të ndryshme. Me këtë deklaratë, kryebashkiaku Veliaj paralajmëroi gruan e ish-kryeministrit Nano, Xhoana Nanon që të lironte ambientet.



Xhoana Nano

nos, bashkëshortja e ish-kryeministrit Fatos Nano, me argumentin se është ndryshuar qëllimi i shfrytëzimit të ambientit të stadiumit pronë e Bashkisë. Në këto kushte, sqaronte bashkia në vendimin e 23 tetorit, i lind e drejta të prishë kontratën. Bashkia argumenton se objekti në stadiumin "Selman Stërmasi" ka pasur një kontratë 20-vjeçare për përdorimin si restorant për udhëtarët, ndërkohë që nuk shfrytëzohet më për këtë qëllim. Vendimi i bashkisë i është drejtuar administratorit të klubit Tirana, Refik Halili.

RIKONSTRUKSIONI I STADIUMIT

Stadiumi "Selman Stër-

KONTRATA

Xhoana Nano ka hedhur në gjyq bashkinë e Tiranës, e cila rreth një jave më parë vendosi të prishë në mënyrë të njëanshme kontratën që kompania "Joy Travel" kish lidhur me Ministrinë e Financave për të shfrytëzuar ambientet e stadiumit "Dinamo" për biznes.

"Joy Travel"

Vendimi i bashkisë i është drejtuar administratorit të klubit Tirana, Refik Halili.

masi" i është nënshtruar rikonstruksionit prej disa muajsh dhe se është një investim që po bëhet nga bashkia dhe federata. Në vazhden e këtij rikonstruksionit, bashkia u ka kërkuar të gjithë bizneseve që të lirojnë ambientet e zëna, pasi ato tashmë do vihen në shërbim të sportistëve dhe administratorit të këtij stadiumi. Nisur nga kjo situata, bashkia paralajmëroi se nëse këto biznese nuk ikinin vullnetarisht atëherë bashkia do ndërhynte forcërisht, duke i prishur ato.

Pritet që të gjitha këto ambiente të bëhen pjesë e ekipit të Tiranës, i cili pritet që në vitin në vijim të ketë një sponsorizim financiar më të mirë nga bashkia e kryeqytetit.

RESTORANT "PULËBARDHA"

Pak javë më parë Bashkia e Tiranës prishi kontratën mes Ministrisë së Financave dhe restorantit "Pulëbardha" që figuron me NIPT sekondar të kompanisë "Joy Travel" në pronësi të Xhoana Na-

Nëna e Konomit: Burrin ma vranë, e gjeta të gjakosur

Policia: Babai i Franc Konomit vdekje natyrale, ishte atak

Babai i Franc Konomit i njohur si një nga krerët e bandave më të forta të Tiranës është gjetur i vdekur në banesë në rrethana misterioze dy ditë më parë. Dyshimet e policisë janë se Stefan Konomi 78 vjeç të ketë vdekur nga shkaqe natyrale nga një atak në zemër. Por bashkëshortja e të ndjerit, Kristiana Konomi dyshon se i moshuarit të jetë vrarë për hakmarrje ndaj të shkuarës së djalit të tyre të ekzekutuar, apo për qëllime grabitje. "E kanë vranë.. jam e bindur me fakte. Nuk e di, hasmet e Francit qarkullojnë, huliganë ka sa të duash, drogmenë ka, ata që mbarojnë drogën duan lekë"-tregon e moshuara. Stefan Konomi 78 vjeçar jetonte i vetëm në katin e katërt të një pallati në rrugën "Xhemal Tafaj" në kryeqytet pasi gruaja dhe dy fëmijët jetojnë në Athinë. E moshuara Kristiana Konomi tregon për "Shqiptarja.com" se bashkëshorti i saj nuk i përgjigjej në telefon që prej të enjtes së 5 nëntorit.

ATAKU NË ZEMËR

Lidhur me këtë ngjarje është njoftuar policia dhe ka nisur hetimet. Policia ka ngritur dyshimin se burri i moshuar ka vdekur për shkak të atakut në zemër gjatë kohës që ka qenë në tualet.

NË TELEFON

E moshuara Kristiana Konomi tregon për "Shqiptarja.com" se bashkëshorti i saj nuk i përgjigjej në telefon që prej të enjtes së 5 nëntorit. Kjo mungesë në telefon e ka bërë merak.

je u situat kur me mbërritjen në banesë në Tiranë e gjeti bashkëshortin të shtrirë në korridor, ndërsa në kokë ishte i çarë, i gjakosur dhe i zhveshur. "Të dëmtuar në



Kristiana Konomi, nëna e Franc Konomit



Franc Konomi

kokë e pashë unë se ishte në profil, ishte i shtrirë dhe i kishin hequr edhe rrobat e trupit e kishin lënë nudo, të zhveshur, këmisha ishte atje, ja kishin hequr edhe këmishën e kishin tërhequr zvarrë" - thotë e moshuara Konomi. Lidhur me këtë ngjarje është njoftuar policia dhe ka nisur hetimet. Policia ka ngritur dyshimin se burri i moshuar ka vdekur për shkak të atakut në zemër gjatë

kohës që ka qenë në tualet.

VRASJA E KONOMIT

Franc Konomit, një prej personave të njohur si ndër të fortët e Tiranës u vra në vitin 2010, pranë "Usharit të Panjohur" në rrugën "Luigj Gurakuqi". Që prej asaj kohe, policia ende nuk ka mundur të identifikojë autorët e vrasjes së Konomit. Dy autorët kanë qenë të hipur mbi një motor teksa e kanë ndjekur nga pas

Konomin dhe më pas njëri prej tyre ka qëlluar mbi 7 plumba, duke i shkakuar vdekjen e menjëhershme. Konomi u akuzua për vrasjen e Gazmend Muçës në vitin 1992 në Tiranë, por asnjëherë prokuroria nuk ngriti akuzë kundër tij. Nisur nga kjo situatë mes dy bandave rivale nisi një përplasje e armatosur, me vrasje nga të dyja palët, dhe për pasojë në këto elemente, është vrarë dhe Franc Konomi.

LAJME shkurt

Gara 30 gjyqtarë për 4 vende në KLD

Konferenca e Gjyqësore do të mbledhet në 14 dhjetor për të vendosur mbi katër gjyqtarët që do të jenë pjesë e KLD. Pas përfundimit të mandatit të Dritan Hallunajt, Ilir Mustafarajit, Flamur Kapllanit dhe Dritan Hamitaj do të nisë procedura e përzgjedhjes, ku në garë janë 30 gjyqtarë. Këshilli ekzekutiv planifikuar të mbahej më 26 tetor të këtij viti. Por, për shkak të angazhimit në reformën në Drejtësi u vendos që mbledhja të mbahet më 14 dhjetor 2015.



Ekstradohet Ish-lojtari i Kombëtares

Ish-lojtari i kombëtares së moshave dhe disa ekipëve në Shqipëri, Guido Tepschi, është ekstraduar nga Shqipëria drejt Italisë, pasi akuzohet për pjesëmarrje në organizatë kriminale dhe trafik kokainë. Guido Tepschi u arrestua më korrik nga autoritetet shqiptare për llogari të drejtësisë italiane. Futbollisti 24 vjeçar nga Durrësi, akuzohet nga Itali si anëtar i një organizate kriminale që ka trafikuar 15 kokainë nga Holanda në Itali, në periudhën korrik 2013-qershor 2014.

Noterja kaloi pronën tek një shtetas e vdekur

Një notere është vënë në pranga nga efektivët e policisë së Dibrës nën akuzën e shpërdorimit të detyrës dhe falsifikimit të dokumenteve. Noterja 47 vjeçare Majlinda Jangulli, e cila ushtronte detyrën në qytetin e Peshkopisë, është ndaluar pasi rezultoi se ka përpiluar një kalim pronësie në emër të shtetasit N. K., e cila rezultoi të ketë vdekur në vitin 2004. Blutë e Dibrës ndaluan edhe 32 vjeçarin Ylber Lami, pasi ka nënshkruar një kontratë shitblerjeje, me një shtetas, i cili nuk ka qenë prezent.

Gjykata e Lartë Prishi godinat Pretenca, deputeti Veliaj, rrezikon 10 mln lekë gjobë

Një milionë lekë të rinj është gjoba që prokuroria e Përgjithshme kërkon të paguajë deputeti i Partisë Demokratike Astrit Veliaj, i vënë nën akuzë për prishje të pronës publike. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë do të marrë vendim për detyrimin më 20 nëntor, ndërsa i pranishëm në sallë Veliaj kërkoi pajfësi duke e quajtur të pazabazur pretendencën e prokurorit Altin Binaj. Deputeti Veliaj akuzohet se ka prishur godinën e ish-drejtorisë së Policisë së Fierit për të ndërnuar universitetin privat "UFO" në këtë qytet. Vetë deputeti i djathtë thotë se kjo ndërtesë është hequr prej vitesh nga lista e pronave shtetërore e Ministrisë së Brendshme. Veliaj u mor si i pandehur 8 muaj më parë, fillimisht me akuzën e ndërtimit të paligjshëm dhe prishjes së pronës publike, por pas amnistisë për ndërtimet pa leje, prokuroria mbeti përballë Gjykatës vetëm me një akuzë, atë të shkatërrimit të pronës.

TRANSAKSIONI/ PROKURORIA NIS HETIMET Hakerat Bullgarë, i vjedhin farmacisë 215 mijë € nga banka

Një kompani farmaceutike në kryeqytet ka rënë pre e mashtrimeve kompjuterike nga hakerat bullgarë të cilët kanë arritur t'i vjedhin 215 mijë euro. Kallëzimi për këtë rast është bërë një ditë më parë në Policinë e Tiranës e cila tashmë ka nisur hetimet duke i kërkuar ndihmë dhe interpolit. Burime për "shqiptarja.com" bënë me dije se kompania e cila ka rënë pre e mashtrimit është D.Ph me seli në Tiranë dhe kallëzimi për këtë rast është bërë nga financierja e kësaj kompanie në polici. Ka qenë një e-mail i mbërritur në zyrën e financës që njoftonte financierin L.T për një pagesë që kompania shqiptare duhet të bënte në një llogari bankare në Sofje të Bullgarisë. Kjo pagesë është kryer me anë të transaksionit online nga llogaritë bankare të kompanisë në drejtim të një banke në Bullgari. Pa kaluar shumë kohë nga bërja e pagesës është kuptuar nga vjedhja pasi firmës shqiptare nuk i rezultonte një borxh i tillë apo porosi e bërë nga ndonjë grossist në Bullgari. Ky kallëzim i është referuar dhe sektorit të krimeve kompjuterike në Prokurorinë e Tiranës të cilët



tashmë kanë nisur letërporsi drejt bullgarisë për të identifikuar personat që kanë tërhequr shumë prej 215 mijë euro. Ky nuk është rasti i vetëm që hakerat bullgarë arrijnë të vjedhin nga llogaritë e kompanive dhe shtetasve të ndryshëm shqiptarë shumë të konsiderueshme lekësh. Në disa raste ata janë arrestuar teksa vjedhin bankomate, ku rasti i fundit

4 BULLGARE

Rezultoi se dhe katër shtetas të tjerë Bullgarë janë shpallur në kërkim ndërkombëtar nga prokuroria, pasi ata kanë qenë në Shqipëri dhe kanë pasur aktivitet kriminal në hakërimin e bankomateve me karta të klonuara.

ka qenë ai i grabitjes së bankomatit të një qendër biznesi dhe një bankomat pranë Drejtorisë së Policisë së Tiranës. Ndërkohë rezultoi se dhe katër shtetas të tjerë Bullgarë janë shpallur në kërkim ndërkombëtar nga prokuroria, pasi ata kanë qenë në Shqipëri dhe kanë pasur aktivitet kriminal në hakërimin e bankomateve me karta të klonuara.

JU TREGOJ 'SEKRETET' E DREJTIMIT

Flet ish-kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Tiranës dhe ish-drejtor i Kombinatit Kimiko-Metalurgjik të Laçit



FATOS PUTO



NESIP IBRAHIMI

Lindi në Gjirokastrë më 20 korrik 1932. Kreu shkollimin, deri në të mesmen, po në Gjirokastrë. Në Tiranë ndoqi shkollën e mesme profesionale, e njohur me emrin "Shkolla Teknike". Në periudhën 1948-1952 punoi si mekanik në ish-Uzinën "Enver" në Tiranë. Mbaroi Universitetin Shtetëror për Inxhinieri Mekanike. Përgjegjës sektori në Komitetin Ekzekutiv, kryetar i Bashkimeve Profesionale të Tiranës. Për 14 vjet punoi në Kombinatin Kimiko-Metalurgjik të Laçit si inxhinier, kryeinxhinier dhe drejtor. Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit të Tiranës (1975-1983), kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Shkodrës (1983-1986), Doktor i Shkencave në fushën e korrozionit (gërryerjes së metaleve).

kryerja e studimeve nga zyrtarë përkatës në Bashki. Fatkeqësisht, në Tiranë deri tani ka ndodhur që, kur ndërrohet kryetari, ndërrohen edhe projektet për zhvillim, njëjloj sikur Tirana të ishte çiflik i një grupi apo i disa personave dhe jo i të gjithë banorëve të saj. Kur kjo gjë të kuptohet dhe të zbatohet, vetëm atëherë do t'i vihet fre masakrave urbane, që i njohim të gjithë.

Në kohën kur ju ishit drejtuesi më i lartë i pushtetit vendor të Tiranës ka patur kërkesa të jashtëzakonshme për strehim. Ekzistonte, si të thuash, një kontradiktë ndërmjet ndërtimeve të kufizuara me pak kate dhe kërkesave gjithnjë në rritje të popullatës. Sa në siklet e ndjenit veten, në një kohë që trysnia për dhënie banesash vinte thuajse nga të gjitha anët: Byroja Politike, Komiteti Qendror, Kryeministria, Presidencia, ministratë, këshillat popullore të rajoneve, etj?

Atëherë nuk kishte lëvizje të lirë të njerëzve dhe për strehimin kishte një plan vjetor. Banesat me plan logariteshin në rreth 2.800 apartamente në vit, ndërsa banesa me kontribut vullnetar 1.800 apartamente. Ndërsa Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes ndërtonin dhe i strehonin vetë punonjësit e tyre. Komiteti Ekzekutiv i Rrethit u merrte ministrive dhe ndërmarrjeve që ndërtonin me kontribut vullnetar 15% të apartamenteve. Pra, kishte një plan dhe një politikë të caktuar strehimi, por ky plan ishte gjithmonë më i vogël nga kërkesat për strehim, që vinin nga të gjitha anët. Mbar mend një episod: Aty nga fillimi i viteve '80, kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të Shqipërisë, Dritëro Agolli, m'u ankua se shkrimtarë dhe artistë të njohur kishin nevojë të ngutshme për strehim, duke shtuar: «Eja t'i dëgjosh vetë shqetësimet e tyre në mbledhjen e Plenumit të Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve». I thashë Dritëro: "Meqë po më thua se do të jetë prezent edhe sh. Ramiz Alia, atëherë bëj një vërejtje për Komitetin Ekzekutiv, me qëllim që të mund të sigurojmë edhe mbështetjen e tij". Dhe në realitet kështu ndodhi: Nga pjesëmarrësit në Plenum u bënë kërkesa dhe ankesa të shumta për strehim. Në këto rrethana, Ramiz Alia, duke drejtuar gishtin nga unë, iu drejtua të pranishmëve: "Ja ku e kini personin adapt për këtë çështje. Mjafton që atij të mos i mungojë dëshira dhe problemi zgjidhet". Mbarja shënimet e nevojshme dhe, brenda një periudhe relativisht të shkurtër kohore, mundëm të sistemim, në kushte komode strehimi të asaj kohe, rreth 70 shkrimtarë dhe artistë. U ndjeva i lehtësuar dhe mendova se kjo histori mbaroi pozitivisht këtu, por isha gabuar...

Pse, çfarë ndodhi më pas?

Në një mbledhje të afërt të Byrosë Politike, Simon Stefani ngriti problemin se "kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Tiranës ka shkelur vijën e masave, duke lënë pa strehim njerëz nga klasa punëtore, me nevojë të ngutshme familjare dhe duke privilegjuar pa të drejtë me dhoma shtësë

shkrimtarë dhe artistë". Këtë moment e shfrytëzoi Ramiz Alia, i cili iu drejtua Enver Hoxhës: "Nesip Ibrahim nuk pyet njeri për strehimin, por bën me kokën e tij". Kjo ishte e habitshme për mua, pasi ishte vetë Ramizi, që më kishte sugjeruar më parë sistemimin sa më shpejt të disa shkrimtarëve dhe artistëve të njohur.

Dhe cila ishte përgjigja e Enverit?

Përgjigja e Enverit ishte normale dhe dashamirëse, jo ashtu siç shpresonte Ramizi. Enver Hoxha tha: "Thirreni atë djalë dhe shkulin veshin". Dhe, e dini? Personi, që u ngarkua për të më "shkular veshin", ishte Simon Stefani, i katapultuar në Byronë Politike direkt nga klasa punëtore.

Si i keni patur marrëdhëniet me kryeministrin e asaj kohe, Mehmet Shehu?

Deri diku normale. Duke qenë se Tirana kishte një mal me probleme dhe, në kushtet kur unë ballafaqohesha çdo muaj me Këshillin e Ministrave, isha në qendër të kritikave, veçanërisht nga kryeministri Mehmet Shehu, i cili ishte shumë kërkuar. Ai, kur të kërkonte llogari, nuk të lejonte të përdorje shprehje si "do të bëjmë këtë e atë", ose "kemi biseduar për këtë çështje", etj. Pyetjet e tij ishin kryesisht të tipit: "Çfarë ke bërë", ose "pse nuk e ke bërë këtë". Kjo metodë pune mendoj se ishte mjaft efektive, jo vetëm për mua, por edhe për të gjithë ministrat.

Ju vetë a keni patur ndonjëherë përplasje me të?

Përpara se t'i përgjigjem kësaj pyetjeje, dua të them se në punën time dhe në marrëdhëniet me organet më të larta nuk kam patur debate të natyrës politike. Duke qenë një nëpunës shteti, kam punuar me pasion e vendosmëri për të justifikuar besimin që më dha populli i Tiranës dhe për këtë jam ballafaquar me probleme nga më të ndryshmet. Tani, të vijmë te pyetja tuaj. Me Mehmet Shehun, siç u shprehë më lart, kam patur marrëdhënie korrekte pune, me përjashtim të një rasti, kur precipitoni në një përplasje goxha të ashpër. Ishte viti 1980, në mos gajob, Qeveria u kishte vënë detyrë fermerëve të Tiranës që, për çdo lopë, të merrnin 4.000-4.500 litra qumësht në vit. Në konsultim paraprak me specialistët, unë konkludova se një kërkesë e tillë ishte e pamundur të realizohej dhe, në takimin e organizuar me Qeveri, mendimin e kryeministrit e kundërshtova me një batutë: "Shoku Mehmet, nuk mund të marrësh kaq shumë qumësht vetëm me aq pak koncentrat dhe me aq shumë kashtë të ardhur nga Lushnja". I mësuar, me sa duket, të mos i kundërshtonte askush, atij i hpyt gjaku në kokë. "Kush je ti - tha - që kundërshton kryeministrin?! Kush të ka vënë ty në këtë pozicion? Ti duhet të shpallësh armik i pushtetit popullor", e të tjera shprehje, që "nuk i nxinte dheu".

Armik, kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit të Tiranës?

Po, po, kështu u shprehë dhe kjo ishte vërtet shumë e

Kureshtja për të njohur Tiranën e pas kuintave të viteve të monizimit, një kuriozitet i shpjegueshëm për qytetin ku unë jetoj, më ka shtyrë gjithmonë që, si gazetar, të mundja të intervistoj njerin prej kryetarëve më jetëgjatë të Komitetit Ekzekutiv të Rrethit të Tiranës, pa logarituri këtu kryetarët e Bashkisë para vitit '45 dhe pas viteve '90... Nesip Ibrahim ka mbi shpinë 83 vite, por vazhdon të jetë ende aktiv në jetën shoqërore e familjare. E takoj në hyrje të Liqenit Artificial të Tiranës. Teksa zbrit nga automjeti i tij privat, i veshur "shik" dhe me një ecje tepër elegante për moshën, na drejton në një prej bareve aty pranë. Pas këmbënguljes sime, Nesip pranon të japë këtë intervistë për gazetën.

Nga Tirana e viteve të monizimit, sot është gati e pamundur të gesh diçka të virgjër. Ndoshta copëza të shpërndara andej-këndej, që zor se mund t'i sistemosh. Është për të ardhur keq që Tirana e dikurshme ende vazhdon të mbetet peng i kujtimeve apo fotografive të një të shkuare të largët... Mjafton të përmendim masakrën e pjesës së Liqenit Artificial, që është pjesa më e dhimbshme e asaj që ka ndodhur me kryeqytetin në këto 25 vitet e fundit. Si ndihet Nesip Ibrahim kur shikon që parqet dhe lulishtet e dikurshme, hapësirat e gjera me bar midis pallateve, kinematë dhe ambientet sportive, tashmë janë zëvendësuar me ndërtime "moderne" apo bar-kafene, që kanë mbirë ngado?

Deri para viteve '90, Tirana ishte një ndër kryeqytetet më të gjelbëruara të Europës. Sigurisht që ndërtime të kohës nuk ishin shumë të bukura, por hapësirat midis pallateve dhe banesave ishin të tilla, që krijonin mjedisë çlodhëse për banorët. Në këto dy dekada e gjysmë, Tirana ka pësuar një zgerim kaotik të jashtëzakonshëm, ku ka qenë e pamundur të evitoheshin gabimet. Shkurt, masakra urbane e bërë në këtë periudhë është e pafalshme dhe me pasojë të riparueshme. Ndërsa ajo që ka ndodhur me kontrat e Liqenit është e dëmshme dhe e dhimbshme. Për të lehtësuar gjendjen, unë mendoj se është e nevojshme

TË TIRANËS TË VITEVE '70-'80

rëndë për mua. Pas këtyre fjalëve, ai mbylli mbledhjen dhe unë u largova "me një mal në kurriz". Fjala e Mehmet Shehut dhe akuzat ndaj meje u botuan madje edhe në buletin e Komitetit Qëndror të Partisë, që dilte atëherë. Por të nesërmen, në mbledhjen e Qeverisë, çudia ishte se vetë Mehmet Shehu më kërkoi falje, në stilin e tij, duke më thënë: "Nesip, të rëndova shumë dje, por, megjithatë, kritika qëndron". Ishte rast i rrallë, që ai të kërkonte falje.

Moslejimi i ekonomisë së vogël gjatë periudhës moniste solli probleme të mëdha në furnizimin e popullit me ushqime, veçanërisht në disa prej artikujve kryesorë si qumësht, mish etj. Ky ka qënë, besoj, një prej preokupacioneve më të mëdha, që kishte atëherë një kryetar Komiteti Ekzekutiv. Si arritët ta menaxhoni këtë problem madhor në kryeqytet, apo edhe në Shkodër më vonë?

Periudha, gjatë së cilës unë shërbeva në Tiranë dhe veçanërisht në Shkodër përkoi me mungesa të shumta në furnizimin e popullit me mallra ushqimorë. Mbyllja e vendit ndaj tregut të jashtëm, mungesa e investimeve, ulja e eksporteve, etj, krijoi deficit të mëdha në të gjitha drejtimet. Erdhi një moment, që u ul shumë niveli i kreditimit të ekonomisë dhe, sigurisht, kjo u ndie menjëherë në furnizimin e tregut me produktet bazë. Fshati ishte në kushte më të vështira dhe puna shkoi deri aty, sa fshatarët

ditur se transferoheshin në Laç, në pozicionin e drejtorit të Kombinatit Kimiko-Metalurgjik.

Ishte pikërisht ky episod, arsyeja e zbritjes tuaj "të butë" në detyrë?

Nuk mund të them se ishte kjo e vetmja arsye. Unë isha inxhinier mekanik, që kisha punuar vite me radhë në Uzinën e Superfosfatit, ndërsa në vitin 1964 isha pjesëtar i një grupi prej 20 vetësh, që shkoi për specializim njëvjeçar në Kinë, për të punuar më pas si kryeinxhinier dhe drejtor në këtë Uzinë. Pra, isha në profesionin tim, të cilin e dashuroja. Specializimi im në fushën e korrozionit (gërryerjes së metaleve) ishte një arsye më tepër për këtë. Madje, edhe kur shërbeja si kryetar i Komitetit Ekzekutiv në Tiranë, dhe më vonë në Shkodër, me porosi të kryeministrit isha pranë problemeve dhe defekteve që ndodhnin në Kombinatin Kimiko-Metalurgjik të Laçit.

Cilat ishin avantazhet ekonomike që kishte Shqipëria nga funksionimi i kësaj uzine?

Në Laç prodhoheshin rreth 140 mijë tonë superfosfat, rreth 80 mijë tonë acid sulfurik, 7 mijë tonë baker, si dhe rafinohej i gjithë bakri që prodhohesh në Uzinën e Rubikut dhe në Fabrikën e Rexhepajit të Kukësit. Prodhohej, gjithashtu, acid nitrik, fluoroosilikat natrumi, etj. Shumica e bakrit ishte për eksport

Nuk duhej të ndodhte, por ja që ndodhi. Shumë gjëra, me njsjen e proceseve demokratike, u shkatërruan. Ishte një dëm i pallogaritshëm. Bujqësia mbeti pa plehra kimike. Shikoni se ç'po ndodh me rendimentet në bujqësi! Nuk e di se sa tonë prodhohen sot, por kam bindjen se duhen disa dekada, që të arrihen ato sasi pletrash kimike që i jepeshin bujqësisë nga Kombinati Kimiko-Metalurgjik dhe nga Azotiku i Fierit.

Në se e kthen kokën 30-35 vite më parë, cilën konsideroni punën më të mirë që keni bërë si kryetar i Komitetit Ekzekutiv të rrethit?

Ka disa gjëra që nuk mund t'i harroj, prandaj po përmend disa prej këtyre punëve të mira:

- Riparimin e dëmeve të tërmetit të vitit 1979 në Malësinë e Tiranës, ku fshati Zall-Bastar u rrafshua komplet, ndërsa Zall-Dajti, Shëngjergji e Kllojka u dëmtuan rëndë. (Brenda një kohe të shkurtër prej 6 muajsh, Zall-Bastari u rindërtua nga e para, me shtëpi të reja, përfshi këtu shkolla, qendra shëndetësore, çerdishe, shtëpi-kulture etj. U ndërtua rruga nga Pëllumbasi në Kllojkë, rruga nga Baldushku në Vrap, rezervuari i Farkës, Kurora e Tiranës, ujëmbledhësi i Skoranit.

-Ndërtimin e Lagjes "Bahçallëk" me vila të reja dykatëshe, si dhe fshatin Dajç, pas tërmetit që ra në Shkodër, ku kjo barrë i takoi Komitetit Ekzekutiv të Tiranës.

- Ndërtimin e Kompleksit Muzeal-Turistik në Pezë, etj.

Në këndvështrimin tuaj, cili mbetet kryebashkiaku më i suksesshëm i Tiranës së pas viteve '90?

Pa diskutim, Edi Rama.

Si një ish-kryetar i Komitetit Ekzekutiv për 8 vite në kryeqytet, çfarë do të vlerësonit në punën e kryebashkiakut aktual, Erjon Veliaj?

Mendoj se është

herët për të gjykuar. Po ndjek me kujdes veprimet e tij dhe mendoj se e ka nisur mirë punën. Prishja e kioskave dhe ngrehinave në hapësirat midis pallateve, krijimi i pesë qarqeve të reja, krijimi i Këshillit Ekonomik për menaxhimin e financave të Bashkisë, zgjerimi me 5,5 hektarë i sipërfaqes së gjelbër në Liqenin Artificial, krijimi i shesh-parkimeve të reja publike, rikonstrukcioni i disa shkollave dhe kopshteve etj, janë punë të mira, realizimi i të cilave u shërben të gjithë qytetarëve të Tiranës. Në këtë rrugë mendoj se duhet të ecë edhe studimi për transportin urban, pasi kaosi i krijuar nga shkarkimi dhe ngarkimi i gjithë periferisë së Tiranës në sheshin "Skënderbej" po e shëmtuan kryeqytetin. Ky djalë ka një shpirt optimist dhe, siç ka thënë Çurçilli, «optimist gjënjë rrugëzgjidhje në çdo vështirësi».

Po ndonjë kritikë apo sugjerim?

E para, në kohën tonë, kryetari i Komitetit Ekzekutiv të Tiranës ishte edhe anëtar i Këshillit të Ministrave (pa të drejtë vote) dhe kjo më jepte mundësinë që disa problemeve t'u jepja përgjigje direkt në mbledhjet e Qeverisë. Mendoj që edhe sot kryetari i Bashkisë, për problematikat e shumta që ka Tirana, duhet të marrë pjesë në mbledhje të tilla, por kjo, sigurisht, nuk varet vetëm nga Erjoni.

E dyta, (pa pretenduar se jam unë i pari që e them këtë), do t'i sugjeroja vendosjen e kujdestarëve të pallateve në të gjithë kryeqytetin dhe kjo punë duhet të fillojë nga pallatet e mëdhenj shumëkatësh. Janë një mori punësh, për të cilat kujdestarët do të përgjigjen, si pastrimi dhe lyerja e shkallëve, kujdesi për ashensorët, sahatet e ujit dhe të dritave, kamerat vëzhguese (aty ku ka), etj. Kjo punë nuk duhet t'u lihet në dorë vetë banorëve, pasi një metodë e tillë nuk ka funksionuar deri tani. Vendosja e kujdestarëve nga Bashkia përkthehet në hapjen e disa mijëra vendeve të reja të punës. Tek e fundit, do të jenë vetë banorët ata, që do t'i paguajnë kujdestarët e tyre, nëpërmjet takses vendore të mbledhur nga Bashkia për këtë qëllim.

Pse pushoi së ekzistuari kjo veper madhore?

NË FOTË:
(majtas)
Nesip Ibrahim
(poshtë) gjatë një takimi në Tiranë



nisën të zinin radhë për të marrë qumësht, mish etj, në lloj si në qytet. Kjo situatë krijoi pakënaqësi, ndërkohe që shteti, me politikat e veta ekonomike, po dështonte. Më kujtohet në vitin 1985 (nuk e mbaj mend datën e saktë), kur ndodheshin në detyrën e kryetarit të Komitetit Ekzekutiv të Shkodrës, më vjen një letër urgjente nga një fshatar (burrë i moshuar) nga zona e Dukagjinit, ku më ftonte të shkoja në fshatin ku ai banonte, për të trajtuar disa probleme me shumë interes për zonën, por edhe për "udhëheqjen lart", siç shkruante ai. E vlerësova këtë informacion dhe u nisa drejt Breg-Lumit, ku banonte letërshtkruesi. Në takimin, që pata me të dhe me disa banorë të tjerë me influencë në atë zonë, midis të tjerave, më thotë: "Ne gjithë jetën kemi rrojtur me blegtori, ndërsa tani na detyrojnë të mbjellim misër. Nuk bëhet misri këtu, kryetar! Edhe ajo sasi që arrin të mbillet, ose vidhet nga fshatarët, ose e hanë derrat. Prandaj, i thuaj shokut Enver që populli i zonës së Dukagjinit është i pakënaqur me këtë gjendje". Duke qënë se një situatë e tillë e konstatova gati në të gjithë Malësinë e Mbishkodrës, vendosa ta përcjell shqetësimin në Qeveri dhe në Komitetin Qëndror. Por, më parë njoftova ish-sekretarin e parë të Komitetit të Partisë të Shkodrës, P.D. Ky i fundit më dëgjoi me kujdes dhe nuk u prononca, por të nesërmen në mëngjes u nis drejt Tiranës, ku, në takimin që pati me Ramiz Alinë, i tha se "Nesip Ibrahim ka mendimin e gabuar që kooperativat bujqësore malore të merren vetëm me blegtori", etj, etj. Nuk kaloi një javë dhe më erdhi "haberi" nga Komiteti Qëndror, ku më bëhej e



APELI

Nuk bëhet misri këtu, kryetar! Edhe ajo sasi që arrin të mbillet, ose vidhet nga fshatarët, ose e hanë derrat. Prandaj, i thuaj shokut Enver që populli i zonës së Dukagjinit është i pakënaqur me këtë gjendje"

ADMIRINA PEÇI

Pas botimit të pjesës së parë të dokumentit sekret dërguar në Komitetin Qëndror me 10 gusht 1972, mbi spiunimet dhe kundërshtitë në Lidhjen e Shkrimtarëve, vjen sot pjesa e dytë dhe e fundit e këtij dokumenti, hartuar në drejtorinë e Punëve të Brendshme, Tiranë. Dokumenti zbërthen thelbin e anës së errët të regjimit komunist, funksionimin e levave të tij përmes spiunimeve dhe luftës së paprincipitë brenda llojit.

Në këtë raport të Drejtorisë së Punëve të Brendshme informatat e mblodhura nga bashkëpunëtorët e Sigurimit zbulonin një përplasje mes Fatos Arapi dhe Ismail Kadarese. Sipas tyre Fatos Arapi kishte botuar një novelë me titullin "Dikush më buzëqeshje", ku përflitej se aty me një personazh negativ autori kishte portretizuar Kadarenë. Prej këtu nis një intrigë e gjatë thashethemesh e raportimesh, ku sipas raportit të Sigurimit një klan shkrimtarësh e kritikësh ishin shfaqur hapur në luftë kundër shkrimtarit Ismail Kadare.

Si një dokument me përmbajtje mjaft delikate, siç janë shumica e dokumentëve që dilnin nga zyrat e Sigurimit të Shtetit, sot mund të ngjallë edhe reagime të vetkuptueshme. Por publikimi i tij mund të vlejë si dëshmi e fortë për shkallën e paprecentit të survejimit të jetës së shkrimtarëve dhe artistëve në vite te regjimit, duke depërtuar në çdo bisedë, a mendim të shfaqur, qoftë edhe mes dy miqve kokë më kokë. Mund të vlejë si matës i helmimit të ndërjegjes së njerëzve, tek të cilët përmes levave të tij, regjimi ia dilte të nxiste konflikte, smirë, ego të sëmurë dhe klane të forta, e si rrjedhojë kushte perfekte për t'i mbajtur ata nën frerë e në shërbim të ideologjisë së komuniste.

Pjesa e dytë e dokumentit, fokusohet më shumë në "shprehje e shfaqje mendimesh me karakter armiqësor", ku sipas informatorëve të Sigurimit, pikëpamje këtu kishin shfaqur Fatos Arapi, Viktor Qurku, Sulejman Mato, Pandeli Koçi, Bujar Kapexhiu, Llambi Blido, Janaq Paço etj...

Në raport theksohet se disa nga shkrimtarët, poetët, piktorët, etj., si Faik Ballanca, Pandeli Koçi, Sulejman Mato etj., studionin shumë literaturë kosovare dekadente, të cilat i qarkullonin te njëri-tjetri. Lupa së vëzhguesve të Sigurimit nuk u shpëtonin as piktorët. "Një burim thekson se "Bujar Kapexhiu, Llambi Blido etj., janë të dhënë mbas izmave në pikturë. Ata marrin libra e revista të huaja me përmbajtje dekadente. Dhe kjo literaturë ka ndikuar në veprat e tyre, mbasi disa herë, p.sh., Llambit nuk i janë pranuar punimet për shkak të përmbajtjes dhe të ngjyrave. Bujari është i dhënë shumë mbas kubizmit në ilustrimet, në karikaturat dhe skenat e estradës, disa nga të cilat i ripunon..."

Në ansambël informatorët e Sigurimit thonin se kishte pakënaqësi ndaj Milto Vakos.

Ja çshkruhet në raport për atmosferën në ansambël: "Lefta Mulliri është revoltuar dhe ka shprehur mendimin për t'u larguar nga Ansambli mbasi nuk punohet me Milto Vakos, sepse është intrigant dhe të punon njëmijë të këqija... Në dhjetor (1971) burimit i kanë vajtur Basim Zekthi, Lefta Mulliri dhe Mediha Labonja dhe i kanë dalë me propozim të largohen nga Ansambli, mbasi po bëhet i padurueshëm qëndrimi këtu".

Më poshtë sjellim pjesën e dytë të dokumentit.



SIGURIMI

FATOS ARAPI U REBELUA PSE S'BOTOI DRITA NJE POEME KUNDER FEMJEVE TE UDHEHEQESVE

"Kjo poemë ngrinte si problem shqetësues se fëmijët e udhëheqësve bredhin e bëjnë qejf me veturat luksoze në një kohë kur në jetën tonë ka plot shqetësime. Pse të mos botohet kjo poemë ngul këmbë Fatosi që ngre probleme kaq jetike dhe reale..."

(Vijon nga dje)

PJESA E DYTË E RAPORTIT

Siç u theksua edhe më lart, diskutimet, konsideratat dhe vlerësimet e bëra mbi baza të sëmura, në disa shkrimtarë e artistë, kanë sjellë për rrjedhim krijimin e disa ambienteve që kanë për prirje nga njëra anë, mbështetjen dhe mbrojtjen e shoku-shokut dhe, nga ana tjetër, kundërvënien njëri-tjetrit në forma të ndryshme qosheve dhe në intimitet.

Disa vjet më parë, në prag të Kongresit II të Shkrimtarëve e Artistëve, këta kishin tendencën e ndarjes në "të rinj" e në "të vjetër", të cilët i kundërviheshin njëri-tjetrit. Mirëpo, me gjithë luftën e bërë në mënyrë të vazhdueshme nga Partia, përsëri ekzistojnë ambiente të tilla. Tani flitet se shkrimtarët e artistët ndahen në breza: "brezi i vjetër", "brezi i mesëm", "brezi i ri"; nga disa të therë del se ambientet janë në bazë të tendencave të tyre etj. Duke qenë të tillë ata i kundërvihen njëri-tjetrit. Kështu, sipas burimeve, del se më përpara Ali Abdihoxha, Jakov Xoxe, Filip Ndocaj etj., kanë qenë për novatorizmin e përfaqësuar nga ana e tyre, kurse këto vite e fundit, meqenëse e shikojnë se Ismaili, Dritëroi etj., janë afirmuar dhe kanë sukses, kanë hyrë në konflikt me ta duke përdorur si bazë edhe formën e të shkruarit - të gjatë apo të shkurtër. Aliu e të tjerë, romanet e këtyre i konsiderojnë reportazhe; bile ndonjë ka mendimin se ato kanë rënë nën ndikimet


e huaja moderniste. Shkrimtarët e "brezit të mesëm" vazhdojnë të thonë se të vjetrit si Llazzar Siliqi, Ali Abdihoxha etj., janë konservatorë. Bile kanë thënë edhe për shkrimtarin Dhimitër Shuteriqi se më përpara ka qenë i tillë, kurse më vonë është bërë ekulibrist dhe ndjek opinionin. Të rinjtë si Sulejman Mato, Viktor Qurku etj., kërkojnë të dalin në arenë dhe meqenëse nga niveli janë më të ulët se Ismaili e Dritëroi, i mohojnë ata si të zotë. Viktori thotë se Dritëroi është si gjithë të tjerët. Ai p.sh., për poezinë "Krevati i perandorit" të Dritëroit është shprehur se nuk është poezi serioze dhe nuk është për t'u ngritur aq lart, ashtu siç veprohet.

Por, përveç këtyre diskutimeve e bisedimeve, që mendojmë se e kanë bazën në egoizmin profesional, në disa elementë nga radhët e shkrimtarëve dhe artistëve konstatohen edhe shprehje e shfaqje mendimesh me karakter armiqësor. Pikëpamje këtu del se kanë shfaqur Fatos Arapi, Viktor Qurku, Sulejman Mato, Pandeli Koçi, Bujar Kapexhiu, Llambi Blido, Janaq Paço etj.

Viktor Qurku është ndikuar nga literatura revizioniste sovjetike. Ai është shprehur se "unë lexoj art të vërtetë, dëgjoj në radio konkursin që bëjnë poetët e sotëm sovjetikë, këto vjersha janë art i vërtetë që të luan mendja e kokës... Unë do të shkruaj vjersha të errëta që nuk kuptohen, nuk më pëlqen asgjë nga poezia e sotme shqiptare..., simpatizoj poetët e kohës së Jevtushenkos...". Një burim tjetër informon se, duke folur për Jevtushenkon në



Fatos Arapi



një kohë kur gazeta "Drita" e kritikonte atë, Viktori ka thënë: "... hiqni emrin Jevtushenko, vini një emër tjetër të një poetit tonë dhe poema është e mrekullueshme". Në një rast ai i ka thënë Dritero Agollit: "Ik se ty të kanë bërë të madh se i këndon Partisë, se të kanë me sy të mirë të mëdhenjtë". Për pikëpamje të tilla Viktori është këshilluar nga ana jonë vitin e kaluar.

Sulejman Mato ka gjithashtu mendime të shtrembra sidomos në disa poezi, të cilat redaksia e "Dritës" nuk i ka botuar për shkak se përmbajtjet e tyre janë ideologjikisht të gabuara. Bile kohët e fundit ka paraqitur për botim një poezi ku, nën pretekstin e luftës kundër burokratit, godet ata që kanë makina. Lidhur me këto poezi një burim na njofton se "... para pak kohësh, duke biseduar me Pandeli Koçin, i cili ka redaktuar vëllimin me poezi të S. Matos, më tha se Sulejmani është i papjekur dhe ai, duke u nisur nga tendenca se poeti duhet të jetë trim dhe të godasë çdo të metë, ka bërë një poezi mbi tipin e burokratit, e cila është me përmbajtje thellësisht reaksionare, mbasi godet njerëzit

që kanë veturë. Sulejmani thotë se burokrati duhet kërkuar dhe goditur në veturat dhe jo ku e kërkojnë shkrimtarët".

Fatos Arapi, përveç përpjekjeve për denigrim të I. Kadaresë etj., ka shfaqur dhe mendime ideologjikisht të shtrembra. Nga një burim del se Fatosi, duke qenë prezent S. Mato, V. Mato, etj., ka justifikuar dhe insistuar që të botohet poezia e Sulejmanit, për të cilën u fol më lart. Burimi informon: "Fatosi i përkrahur nga Sulejmani dhe Vullneti, po e sulmon kryeredaktorin e "Dritës", duke i thënë se ajo gazetë nuk po boton shkrime të guximshme në përgjithësi dhe poezi në veçanti. Fatosi thoshte se aty botohen vazhdimisht poezi problematika që nuk thonë asgjë. Duke i thënë kryeredaktorit se duhet të revolucionarizohesh e të botosh poezi

NË FOTO:
Faksimile të raportit të Sigurimit

me përmbajtje të guximshme, Fatosi solli si shembull mosbotimin në gazetën "Drita" të një poeme të S. Matos. Siç u mësuva më vonë (si rezultat i komentimit në ambientin e tyre), kjo poemë ngrinte si problem shqetësues se fëmijët e udhëheqësve bredhin e bëjnë qejf me veturat luksoze në një kohë kur në jetën tonë ka plot shqetësime. Pse të mos botohet kjo poemë ngul këmbë Fatosi që ngre probleme kaq jetike dhe reale...". Përveç kësaj, Fatosi ka shfaqur pakënaqësi edhe lidhur me pagesën për veprat letrare. Ai ka thënë: "... në vendin tonë pagesat për vepra letrare janë jashtëzakonisht të ulëta, më të ulëta në botë. Me një pagesë të tillë simbolike është e pamundur të krijohen kushte të mira për shkrimtarët dhe të krijohen vepra të mira. Për një vepër shkrimtari jashtë siguron jetën për 10 vjet ... Pse do të borgjezohet ky (burimi) po t'i jepem 10 000 lekë për romanin që botoi? Aspak, përkundrazi...".

Disa nga shkrimtarët, poetët, piktorët, etj., si Faik Ballanca, Pandeli Koçi, Sulejman Mata etj., studiojnë shumë literaturë kosovare dekadente, të cilat i qarkullojnë te njëri-tjetri. Një burim thekson se "Bujar Kapexhiu, Llambi Blido etj., janë të dhënë mbas izmave në pikturë. Ata marrin libra e revista të huaja me përmbajtje dekadente. Dhe kjo literaturë ka ndikuar në veprat e tyre, mbasi disa herë, p.sh., Llambit nuk i janë pranuar punimet për shkak të përmbajtjes dhe të ngjyrave. Bujari është i dhënë shumë mbas kubizmit në ilustrimet, në karikaturat dhe skenat e estradës, disa nga të cilat i ripunon, por nuk bindet duke thënë se jeni kundër të resë, se nuk do të eci përpara deri se keni këto mentalitete. Në sfondet e estradës ka tendenca të huaja, p.sh. në numrin e fundit të estradës ai kishte një skenë me trekëndësha të pakuptueshme...". Një burim tjetër njofton se Bujari ka shfaqur mendime të tilla të karakterit armiqësor: "S'të kuptojnë këtu, të jesh andej bën namin... E di unë si e duan këta shfaqjen, ta mbushësh me flamurë e me artikuj gazetash dhe je në rregull... Shfaqja dhe bukur ishte "Njolla të murrme" që u kritikua, ajo ishte tamam si shfaqje e huaj... Kemi mbetur akoma me kohën e Nuhit, bota po bën mrekull... jashtë nuk janë më të zgjuar se artistët, por atje ka liri veprimi të formave artistike, ndërsa këtu te neve bëhen shfaqje me porosi, të më lënë mua dhe të shikosh, ta bëj unë shfaqjen që të thyhen dyert, po kush të lë...". Pikëpamje të tilla ka edhe piktor Llambi Blido. Ai është shprehur: "... Kush të lë të punosh këtu si do ti, kush të lë bësh diçka të re, na ndrydhin ndjenjat tona, jemi shumë prapa botës, spektatorët nuk kuptojnë pikturën tonë se janë pa kulturë, vetëm i huaji di të na çmojë...".

Për krijimtarinë artistike që lidhet me repertorin e teatrove, gjithashtu qarkullojnë se ato janë monopolizuar me veprat e vetëm disa autorëve, siç janë Ibrahim Uruçi, Fadil Paçrami, Nikolla Zoraqit etj. Vath Koreshi i ka thënë një burim tonë se "... është duke përfunduar një dramë të re, të cilën ua kam dhënë disa-ave dhe ata janë entuziastë... por belaja është se ku ta vë në skenë. Teatrin Popullor e kanë okupuar Fadilet e Ibrahimët. Ma kanë punuar edhe një herë kështu me një dramë tjetër... E çova në Teatrin Popullor, e pëlqyen dhe e aprovuan, mirëpo e mori

vesh Ibrahimimi që nuk aprovuan dramën e tij "Shembja" dhe nuk la derë pa trokitur, vajti gjer në KQ dhe ai përfundim Teatri mori urdhër të vinte në skenë dramën e Ibrahimit...".

Një burim tjetër njofton se "flitet shumë se Teatri Popullor vë në skenë vepra që janë të ulëta artistikisht, por vihen se janë të Fadil Paçramit dhe Ibrahim Uruçit... Meqenëse janë të këtyre zgjidhen dhe angazhohen aktorët më të mirë, me qëllim që drama të mund të pëlqehet. Aktorët i zgjedh vetë Fadili dhe guxo të bësh vërejtje po deshe se të mbyl. Atëherë ndodh që, meqenëse të metat nuk diskutohen hapur, më vonë bisedohet midis nesh për ato të meta (në intimitet). Në këtë mënyrë na kanë folur Pjetër Gjoka e Petro Marko, por ka edhe të tjerë...". Po ky burim vazhdon: "... Para 5-6 muajsh aktori Pjetër Gjoka më ka thënë se në teatër janë ndarë artistët në tarafe që luftojnë njëri-tjetrin. Por atje ka miq shoku Fadil dhe që ta bësh të tillë atë duhet t'i lavdërosh dramën. Fadil u ka thënë të tjerëve për mua se është jezuit...". Burimi thotë se edhe Sandër Banushi, Lazar Siliqi e Ndrek Luca ma kanë thënë se Fadil Paçrami lufton katolikët shkodoranë dhe mbron myslimanët...". Nga një burim tjetër rezultojnë se Bujar Kapexhiu së, duke folur rreth dramës së F. Paçramit është shprehur se "... unë jam i bindur se ajo është një shfaqje e dobët dhe mori cmimin vetëm se e ka shkruar F. Paçrami...".

Kompozitori Shpëtim Kushta thotë: "Teatri i Operës është bërë pronë e Nikolla Zoraqit. Çdo gjë që kompozon ai vihet në dispozicion të Teatrit. Veprat e kompozitorëve të tjerë refuzohen, ose edhe kur pranohen për ato refuzohen shumë pak kujdes në përgatitje, ndërsa për ato të Zoraqit bëhet punë e madhe...". Një burim tjetër njofton se "të gjitha punimet e repertorit të Ansambllit janë përqendruar në duart e Milto Vokos, Agim Krajkës e diçka Tish Daisë. Prej shumë vitesh kompozitorët e tjerë nuk kanë dëshirë të punojnë për Ansambllin. Ata thonë se neve nuk na afrojnë më edhe kur kemi dërguar ndonjë pjesë, vepra jonë është ndryshuar në ekzekutim dhe udhëheqja artistike e bën këtë sepse ka guston e vet ... Flitet nga shumë artistë se Koço Vasili vetë firmos dhe vetë vulos. Prapa tij është Zhani Ciko që e përkrah, gjithashtu ka vite që në këtë teatër preferohet vetëm Nikolla Zoraqit, kurse kompozitorët e tjerë nuk afrohen dhe nuk ekzekutohen veprat e tyre, bile në sirtarët e drejtorisë së Operës ka veprat të kompozitorëve që nga ana financiare janë paguar, por nuk ekzekutohen, ose të tjerëve nuk u kthehet përgjigje fare. Kështu që nga disa kompozitorë janë krijuar bindje se luftohen nga drejtuesit e Operës, prandaj dhe nuk shkruajnë...". Një burim tjetër, para disa kohësh, theksonte se "në Ansambllin Shtetëror të Këngëve e Valleve është krijuar pasiguri në radhët e punonjësve, gjë të cilën ia dedikojnë udhëheqësit artistik Milto Vako...". Lefta Mulliri është revoltuar dhe ka shprehur mendimin për t'u larguar nga Ansambli mbasi nuk punohet me Milto Vakon, sepse është intrigant dhe të punon njëmijë të këqija ... Në dhjetor (1971) burim i kanë vajtur Basim Zekthi, Lefta Mulliri dhe Mediha Lubonja dhe i kanë dalë me propozim të largohen nga Ansambli, mbasi po bëhet i padurueshëm qëndrimi këtu".

- Këto janë disa nga çështjet që janë diskutuar e diskutohen ndër shkrimtarët e artistët, sigurisht jo në mbledhje të hapëta, por në rrethe të ngushta. Mendojmë se nga mënyra se si bisedohet dhe ngrihen këto probleme në ambiente të caktuara, tregon se në këtë drejtim duhet bërë një punë e madhe në radhët e shkrimtarëve e artistëve nga ana e Partisë dhe e organizmave të saj. Ndërsa nga ana jonë është bërë vlerësimi për ato që janë karakter haptazi politik dhe do të forcojmë punën tonë për zbulimin qysh në fillim të veprimtarisë armiqësore që mund të dëmtojë vijën e Partisë në këtë terren të rëndësishëm ideologjik.

DREJTORI I PUNËVE TË BRENDSHME (RAQI IFTCHA) dv



REPUBLIKA E SHQIPERISE


MINISTRIA E ENERGJISË DHE INDUSTRIE

LLOJI I PASURISË SË PALUJTESHME QË SHPRONËSOHET: TOKE ARË, TRUALL, PYLLE, KULLOTË

Nr.	Numri i shtyllës	Të dhëna për pronësinë							Sip. Shpronësim shtyllë m2	Vlera e Shpronësimit në Lek/m2	Vlera e Shpronësimit në Lek per shtyllë	Shënime
		Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Sastë Sip pronës m2				
FSHATI RASHBULL												
					3215							
1	110	Tefik	Muharrem	Kallulli	3215	59/4	Are	2835	17.4	227	3949.8	
2	1	Tefik	Muharrem	Kallulli	3215	59/4	Are	2835	82.92	227	18822.8	
3	2A	Fatmir		Frahulli	3215	59/3	Are	300	51.84	227	11767.7	
4	2	Isuf	Kasem	Dervishi	3215	53/6	Are	3500	34.33	227	7792.9	
5	3	Pretendues			3215	53/7	Are	2500	96.04	227	21801.1	
6	4	Pretendues			3215		Arë		106.27	227	24123.3	
7	5	Pretendues			3215		Arë		34.33	227	7792.9	
8	6	Pretendues			3215		Arë		77.33	227	17553.9	
9	7	Pretendues			3215		Arë		74.02	227	16802.5	
10	8	Pretendues			3215		Arë		62.5	227	14187.5	
11	9	Pretendues			3215		Arë		34.33	227	7792.9	
FSHATI ARAPJ												
					1031							
12	11	Muharrem	Ibrahim	Pajaziti	1031	126/14	Are	1150	94.09	356	33496.0	
13	12	Pretendues			1031	192/7 192/8	Are	8700	77.33	356	27529.5	
14	14	Besim	Kadri	Tropolini	1031	242/10	Are	3760	42.82	356	15243.9	
15	15	Pretendues			1031		Are		34.33	356	12221.5	
16	16	Pretendues			1031		Are		41.46	356	14759.8	
FSHATI SHKALLNUR												
					3385							
17	17	Ramazan	Seit	Mucaj	3385	133/2	Are	2500	94.09	227	21358.4	
18	18	Egerem	Sabri	Muca	3385	133/5	Arë	7400	43.88	227	9960.8	
19	13 A	Mustafa	Jakup	Dervishi	3385	146/1-2	Arë	540	51.84	227	11767.7	
20	19	Bashkepronesi			3385	131/1	Arë	1350	58.32	227	13238.6	
21	20	Demir	Ramazan	Xhafa	3385	264/16	Arë	4900	40.56	227	9207.1	
22	21	Pretendues			3385		Arë		34.33	227	7792.9	
22	22	Bashkepronesi		Berberi	3385	433/5	Arë	2000	34.33	227	7792.9	
24	23	Pretendues			3385	490/4 491/1-10	Arë		34.33	227	7792.9	
25	24	Gezim	Copa		3385	535/8	Arë	2400	34.33	227	7792.9	
26	25	Robert	Myfolllari	Puja	3385	565/20	Arë	7000	48.72	227	11059.4	
		Mynre				565/21	Arë	6000				
FSHATI KRYEMEDHENJ												
					2291							
27	26	Pretendues			2291	3/2 -	Arë		58.32	345	20121.7	
28	27	Xhemile	Ahmet	Sinarezi	2291	16/5/1	Arë	2300	34.33	345	11843.1	
29	28	Bashkepronesi		Dervishi	2291	26/2	Arë	2140	34.33	345	11843.1	
30	29	Azem	Islam	Dervishi	2291	70/6	Arë	1000	34.33	345	11843.1	
		Fatmir	Islam	Dervishi	2291	70/7	Arë	1100	34.33	345	11843.1	
31	30	Haxhi	Abdulla	Istrefi	2291	135/9	Arë	950	34.33	345	11843.1	
32	31	Hamid/ Shtet	Reshat	Shirja	2291	169/2 196/7	Arë	1000	34.33	345	11843.1	
33	32	Bashkepronesi		Shirja	2291	167/6	Arë	4600	77.33	345	26680.4	
34	33	Pretendues			2291	215/3	Arë		34.33	345	11843.1	
35	34	Petrit	Shefik	Tila	2291	215/7	Arë	10100	34.33	345	11843.1	
36	36	Pretendues			2291		Arë		58.32	345	20121.7	
37	37	Pretendues			2291	423/2 423/2	Arë		77.33	345	26680.4	
38	38	Pretendues			2291	425/8	Arë		47.33	345	16330.4	
FSHATI GOLEM												
					1791							
39	39	Pretendues			1791		Arë		112.36	345	38764.2	
40	40	Pretendues			1791		Arë		112.36	345	38764.2	
41	41	Pretendues			1791		Arë		40.56	345	13993.2	
42	31 A	Pretendues					Arë		73.96	345	25516.2	
43	42	Pretendues			1791		Arë		77.33	345	26678.9	
44	43	Pretendues			1791		Arë		34.33	345	11843.9	
FSHATI AGONAS												
					3961							
45	45	Lutfi	Masar	Zikullari	3961	8/1 -	Arë	10000	34.33	238	8170.5	
FSHATI AGONAS												
					3961							
46	47	Pretendues			3961	172/4	Arë		77.33	238	18404.5	
47	48	Besim	Beshir	Spanjollj	3961	35/4	Arë	5220	34.33	238	8170.5	
48	49	Xhevat	Zeqir	Copa	3961	70/4	Arë	12270	34.33	238	8170.5	
49	50	Idajet	Vath	Rruga	3961	71/3	Arë	2000	34.33	238	8170.5	
FSHATI KANAPARAJ												
					2071							
50	51	Pretendues		Spanjollj	2071	511/4	Arë		36.59	345	12623.6	
51	52	Pretendues			2071	512/25	Arë		54.61	345	18840.5	
52	53	Ibrahim	Shefqet	Kanapari	2071	512/20	Arë	12200	82.39	345	28424.6	
53	54	Ylli	Shefik	Kola	2071	750/14	Arë	3600	40.56	345	13993.2	
54	55	Selman	Shaqir	Spanjollj	2071	750/15	Arë	6400				
		Bashkepronesi		Çopa	2071	749/6	Arë	6000	132.25	345	45626.3	
BASHKIA KAVAJË												
KAVAJË												
					8551							
55	56	Pretendues			8551	2/					ska informacion	
56	57	Pretendues			8551	1/					ska informacion	
57	58	Pretendues			8551	1/					ska informacion	
58	59	Pretendues			8551	5/201					ska informacion	
FSHATI GOLEM												
					1791							
59	62	Pretendues			1791	87	Arë		112.36	345	38764.2	
60	63	Pretendues			1791	88	Arë		58.32	345	20120.4	
61	64	Pretendues			1791	56	Arë		77.33	345	26678.9	
SIPËRFAQE TOTALE PËR SHPRONËSIMI NË M²									3254.97			
SHUMA TOTALE NË LEK PËR SHPRONËSIM										967956.8		



BLOG PERIFERI



NGA ALBA MALLTEZI

Shqipëria nuk është një vend për Ju Moikom



Moikom Zeqo

Shqipëria nuk është një vend për njerëzit e brishtë, fëmijë apo të moshuar, gra, nuk është një vend për pensionistët, për njerëzit me mirësjellje e kulturë. Shqipëria nuk është një vend për njerëzit me etikë e harmoni të të mirave e të bukurës. Jo se vendi ynë i mrekullueshëm ku ne jetojmë nuk i përmban këto, përkundrazi, natyra është ndër më të mrekullueshmet që mund të qëllojë të bie në 28 mijë kilometra katrorë: plot diell, ujë, lumenj, male, pemë, laguna, liqere, flutura, pelikanë, re puplore e yje ndriçuese; problemi janë një numër shumë i vogël njerëzish tepër agresivë, arrogantë, përvetësues, kërcënues, grabitës, gojëkëqinj e me uri të pafundme shpirtërore dhe materiale. Këta kanë marrë peng vendin dhe nuk e lëshojnë, e përballë kanë njerëz që në vend të që përballen e t'i përballin ikin, largohen.

Historia e njeriut prej personaliteteve më të nderuar

që kemi sot në hulumtimin e çështjeve të përgjithshme të Arkeologjisë, Artit dhe Kulturës, Moikom Zeqo, publikuar nga e përditshma "Dita" është dëshmi e sa rëndita më lart. Historia e të nderuarit Moikom, është historia e shumë shqiptarëve. I prekur nga një sëmundje e rëndë që kërkon kurim, me siguri shpenzime, ushqim të vegantë, Moikom Zeqo duhet të presë radhët - si shumë shqiptarë të tjerë - për një shtrat...

Nëse në postet e mëparshme shtetërore që ka

mbajtur, Moikom Zeqo, në vend që të bënte punën e tij si pakkush i përkushtuar, në vend që të jetonte gjithë kohën në një apartament modest në Durrës e t'u përgjigjej sajësive të rradhës siç ishte ajo më e fundit me historinë e Kishëzës së Dhërmiut dhe varrit të italianit Nil Katalani, të ishte marrë me grabitje të veprave arkeologjike, apo grabitje të muzeumeve shqiptare, apo trafikime të ikonave apo veprave të tjera të artit, që i kishte nëpër duar më shumë se kushdo tjetër, e sidomos, të kishte pasur

të gjitha mburojat politike majtas e djathtas për krimet që do të kishte bërë, sot do të ishte duke u kuruar në ndonjë klinikë të ngrohtë në Austri apo në ndonjë vend tjetër të Europës, deri në Amerikë.

Por jo, Moikom Zeqo, me çantën e tij, siç e mbaj mend që në ditët e mia të para si gazetarë kulturë në 1994 e largët, ka mbetur i njëjtë: me pak para' e tashmë dhe i sëmurë duke pritur një ditë të tërë një krevat në spital, e duke u kthyer në mbrëmje pa kurën e merituar.

Po fajin kush e ka? Media të paktën qëndron në këmbë, edhe pse duke u lëkundur në misionin e saj fisnik, të tregojë e dëshmojë. Faji është shumë më i gjërë: është i të gjithëve. Është i shumicës, që gjërat që grabiten nga ai grusht njerëzish, duhet të mësojë t'ua marrë me forcë.

Nëse në këto 25 vite do të kishim ndërtuar vërtetë një Shtet që të kujdesej më shumë për masën e madhe të të brishtëve, të moshuarve, fëmijëve, sesa një Shtet që mbron më parë interesat e atyre pak njerëzve me veti të frikshme, nuk do të kishim nevojë të bënim këtë denoncim kaq të trishtuar e kaq denigrues për njerëzit e punës, penës e fjalës.

"TIRANA 2015"

Panairi i librit vjen me temën "E ardhmja e librit dixhital në Shqipëri"

Me temën "E ardhmja e librit dixhital në Shqipëri", Panairi i 18-të i librit "Tirana 2015" do të zhvillohet nga data 11 deri më 15 nëntor në Pallatin e Kongreseve. Ky panair cilësohet si ngjarja më e madhe kulturore e librit që zhvillohet, jo vetëm brenda kufijve të Shqipërisë, por në gjithë hapësirën shqiptare: Kosovë, Maqedoni, Mali i Zi dhe diasporë. Gjatë 5 ditëve të këtij panairi do të organizohen aktivitetet të shumta, si panele, workshope, dy aktivitetet për librin dixhital, një konferencë, një workshop praktik për prodhimin e librit apo dizajnit të librit të digjitalizuar, etj. Ceremonia e edicionit të 18, të panairit të Librit "Tirana 2015" do të mbahet sot në orën 11.00 në sallën ovale të Pallatit të Kongreseve. Siç duket nga programi i panairit, këtë vit do të trajtohet më gjerësisht edhe letërsia shqipe e shkruar jashtë kufijve të Shqipërisë dhe ajo në mërgim, si dhe kultura e ardhshme të Italisë dhe ajo e Çamërisë.

Disa nga zhvillimet më interesante janë promovimi i Revistës "Ylli i dritës me përmbajtje të kulturës arbëreshe. Promovimi i librit "Dardania - Kërkime dhe studime arkeologjike" me autorë Muzafer Korkutin, Luan Përzhitën e Kemajl Lucin; "Në flakët e Izmirit" në praninë e autorit grek Dinosa Koubatis, etj. Një ngjarje interesante do të jetë edhe konferenca e studiueses së njohur italiane Lucia Nadin për "Perspektivat e studimit dhe kërkimit mbi Shqipërinë", që do të mbahet në stendën e Institutit Italian të Kulturës, etj. Në panair do të ketë edhe tryeza të rrumbullakëta, ku do të trajtohen problemet e tilla si "Editoria shqiptare, libri dixhital dhe self publishing. A po i ndryshon teknologjia e web-it (edhe) botimet tona?". Rreth kësaj teme do të mbahet një konferencë e organizuar nga Shoqata e Botuesve Shqiptarë, ku do të referojnë, Bujar Hudhri - E ardhmja e librit në botimet shqiptare, a jemi të vonuar për e-book-un?, Artan



Fuga - Shkrimi në web, përparësi dhe kufizime, Mariana Ymeri - Libër letër apo digjital: mjafton të lexohet (rezultate të një anketimi), Agim Baçi - Nga optika e një lexuesi, etj. DH. HA

Në fokusin e lexuesit online

[SHQIPTARJA.com]

LAJMET MË TË LEXUARA DJE

- Vdes në rrethana misterioze babai i Franc Konomit, gruaje: E vranë!
- Reagojnë Robert Aliaj dhe 'Bobi' pas debatit të mbrëmshëm në show
- E gjëni dot, cili është emri për vajza më i përhapur në botë?!
- 14 foto që do t'ju bëjnë të kuptoni sa çliruese është të jesh natyrale
- Mashtruesi që "peshkonte" vajzat për videokipe dënohet me 2 vite burg
- Video/Rooney sherr gjatë "Keçit" godet me shuplakë wrestlerin Barrett
- Video/ISIS ekzekuton 200 fëmijë
- Ish-lojtari i Kombëtares ekstradohet në Itali për trafikim droge, kokainë
- Kabineti, Patozi: Meta kryeministër Fino: Se besoj t'i imponohet Ramës
- Hakerat i vjedhin 215 mijë euro kompanisë së ilaçeve në Tiranë

LAJMET MË TË KOMENTUARA

- Djegia e flamurit grek, Dule takon Tahirin: Zbuloni autorët e ngjarjes
- Vrau dy turistët çekë, Prokuroria: Të dënohet përjetë Sokol Mjacak
- Itali, donin t'i shpëtonin policisë 2 shqiptarë hidhen në humnërë
- Raporti/ Shreret e artistëve spiunimet për Ismail Kadarënë
- Ikën Drejtoresha e Lojërave të Fatit e zëvendëson djali i Filip Çakullit

VIDEOT MË TË KLIKUARA DJE

De Biasi zbulon listën për ndeshjet miqësore, risi Rey Manaj dhe Veseli

Sarandë, digjet gjatë natës flamuri grek brenda zyrrave të OMONIA-s


Rama: Shqipëria në favor para FMIN-së, nuk do të rriten taksat

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të REPORT TV që shkarkohet falas

SONDAZH I DITES

Pas Naços, a duhet të dorëhiqen ministra të tjerë?

Rezultati i Sondazhit



SHËNIM:

Sondazhet online të Shqiptarja.com, nuk kanë vlerë statistikore. Bëhet fjalë për pyetje që u bëhen të gjithëve dhe jo kamponëve të përpunuar në mënyrë shkencore. Pra, kanë si qëllim të vetëm të lejojnë lexuesit të shprehin mendimin e tyre rreth temave të aktualitetit. Megjithatë, çdo lexues, mund të votojë vetëm një herë në ditë



954 | 227.233
KOMENTET E DJESHME | TOTALI LIKE

DYLBER BALLA
TIRANE

Ndeshja miqësore e futbollit Kosovë-Shqipëri, që do të zhvillohet ditën e premte në Prishtinë, duket se është kthyer në një 'luftë' e ashpër mes dy federatave për grumbullimin e talentëve. E ndërsa deri tani kishte deklarata spontane nga drejtuesit e ekipit të Kosovës, gjatë konferencës së djeshme për shtyp, trajneri Albert Bunjaku ka 'shfryrë' duke akuzuar Shqipërinë se po merr lojtarët e rinj me origjinë kosovare që luajnë në Europë. Bunjaku ka thënë se Shqipëria ka shumë lojtarë të talentuar dhe tani duhet që të lërë që edhe Kosova të ndërtojë ekipin e saj. "Nuk është mirë që kur njëri vëlla ndërton shtëpinë (Shqipëria) t'i marrë gurë prej themeli vëllait tjetër (Kosovës), që po mendon të ndërtojë shtëpinë e vetë. Ne kemi lojtarë mjaftueshëm që të ndërtojmë dy kombëtare. Ne kemi përkrahur deri më tani Shqipërinë, por ka ardhur koha që ne të ndërtojmë skuadrën tonë", ka thënë Bunjaku. Ai bëri të ditur se ka grumbulluar 19 futbollistë, ndër të cilët dy lojtarë që luajnë në ekipe zvicerane, e që do të jenë për herë të parë pjesë e përfaqësueses së Kosovës. Bëhet fjalë për Alban Pnishin dhe Hekuran Kryeziun, për të cilët tha se premtot janë shumë.

ARMAND DUKA

Presidenti i FSHF është shprehur se Kombëtares Shqiptare nuk po i pritët zbarkimi në Prishtinë për ta festuar bashkërisht me gjithë shqiptarët e Kosovës



DEKLARATA

Duka

"Unë jam ndër ata që kam luftuar shumë që Kosova të anëtarësohet në UEFA dhe FIFA. Dua që kjo të ndodhë sa më shpejt. Futbollistët le të zgjedhin, le të përfaqësojnë kë të duan ata, Kosovën apo Shqipërinë", tha Presidenti i FSHF, Duka.

Tifozët

"Që nga themelimi, një ndër misionet bazë të Tifozëve Kuqezi ka qenë që shqiptarët, edhe pse të ndarë në disa shtete, të kenë vetëm një Kombëtare dhe të përfaqësojnë vetëm një Flamur" shprehet tifogrupi më i madh në mbështetje të kombëtares.

Kosova

Bunjaku bëri të ditur se ka grumbulluar 19 futbollistë, ndër të cilët dy lojtarë që luajnë në ekipe zvicerane, e që do të jenë për herë të parë pjesë e përfaqësueses së Kosovës. Bëhet fjalë për Alban Pnishin dhe Hekuran Kryeziun.

'Shpërthen' Bunjaku: Shqipëria po i rrëmben lojtarët Kosovës

Duka: Futbollistët le të zgjedhin si të duan për kombëtaren



Trajneri i Kosovës Albert Bunjaku

kualifikimin historik të saj në Kampionatin Evropian "Franca 2016". "Për ne, vizita në Prishtinë është për të festuar me gjithë popullin shqiptar në atë krahinë, pra më shumë sesa një ndeshje

dhe FIFA. Dua që kjo të ndodhë sa më shpejt. Futbollistët le të zgjedhin, le të përfaqësojnë kë të duan ata, Kosovën apo Shqipërinë. E rëndësishme është që Kosova të pranohet dhe t'i kemi dy shtete shqiptare në Evropë.

një kombëtare, pasi Shqipëria është një komb dhe s'mund të ndahet në dy kombëtare që luajnë kundër njëra tjetrës, qoftë edhe në miqësore. "Që nga themelimi, një ndër misionet bazë të Tifozëve Kuqezi ka qenë që shqiptarët, edhe pse të ndarë në disa shtete, të kenë vetëm një Kombëtare dhe të përfaqësojnë vetëm një Flamur. Ne vazhdojmë të besojmë në kauzën tonë dhe për këtë arsye të premtën nuk do të jemi prezent si grupim në stadiumin e Prishtinës", thuhet në komunikatën e Tifozëve Kuqezi. Por, pavarësisht se nuk do të jenë të pranishëm në stadium ky grupim do të udhëtojë drejt Prishtinës për të shfrytëzuar këtë rast si festë.

"Ne kemi lojtarë mjaftueshëm që të ndërtojmë dy kombëtare, erdhi koha të ndërtohet Kosova", tha tekniku Bunjaku

Këta që janë besoj se do të vazhdojnë me Shqipërinë" deklaroi Duka për "Zërin".

BOJKOT KUQEZI

Tifozët Kuqezi kanë deklaruar se do të bojkotojnë ndeshjen Kosovë-Shqipëri që do të zhvillohet të premtën në Prishtinë për shkak se sipas tyre duhet që të ketë vetëm

futbolli. Por, gjithsesi kjo festë duhet të kurorëzohet me ndeshje futboll që mund të quhet vëllazërore, e jo miqësore. Unë jam ndër ata që kam luftuar shumë që Kosova të anëtarësohet në UEFA

KOMBËTARJA/ PËRGATITJA PËR NDESHJET MIQËSORE

Rei Manaj: Do u mbush mendjen De Biasit dhe Roberto Mancinit

Dy lojtarët e rinj të ftuar për herë të parë në kombëtare Rei Manaj dhe Frederik Veseli komentuan emocionet e përjetuara dhe synimet me fanellën kuqezi. "Patjetër që është një moment i veçantë, që

do të mbetet tepër i rëndësishëm në jetën time. Shpresoj shumë, që ky të jetë prelude i një pjese të rëndësishme, në karrierën time, të cilin do ta kujtoj gjatë gjithë jetës", theksoi Manaj. Më pas sulmuesi i talentuar që luaj me

Interin foli edhe rreth të ardhmes, ofertave dhe besimit të trajnerit Mancini. "Unë jam ende i ri, por sigurisht që edhe unë do bëj punën time për të luajtur në formacion ose të jem i grumbulluar në ekip. Tani do shohim,

vetëm me stërvitje duhet t'i mbush mendjen trajnerit Mancini. Ishin disa skuadra të interesuara për mua, por Mancini tha që nuk mund të lëviz as në janar dhe as vitin tjetër. Mbetet të shohim çfarë do të ndodhë" tha ai. Ndërkohë që mbrojtësi Veseli ishte në të njëjtën linjë me kolegun e tij, që luan aktualisht me Interin. Sipas mbrojtësit, që aktivizohet në Zvicër "Ky është një nga kulmet e karrierës time. Nuk mendoj, për të qenë pjesë e skuadrës që do të shkojë në Evropian, ndonëse se jam i gatshëm që të shfrytëzoj çdo hapësirë që më jepet për ta merituar një gjë të tillë. Është kënaqësi që jam me Shqipërinë. Unë erdha për Kombëtaren, Kosova nuk është ende e pranuar nga FIFA. Kur të thërret Shqipëria për mua është një komb. Kam pasur kontakte prej dy vjetësh me De Biasin, tani të shohim". Aktualisht ekipit kombëtar i futbollit është grumbulluar në Durrës ku po zhvillon përgatitjet për ndeshjen me Kosovën të premtën më 13 Nëntor dhe me Gjeorgjinë më 16 Nëntor.

**Trafik droge
Ish-lojtari
i kombëtares
ekstradohet
në Itali**

Ish-lojtari i kombëtares së moshave dhe disa ekepeve në Shqipëri Guido Tepshi është ekstraduar nga Shqipëria në Itali. Tepshi u arrestua më korrik bashkë me shtetasit Kastriot Dymishi 32 vjeç, Artur Tepshi 49 vjeç, Edmond Tepshi 52 vjeç, Guido Tepshi 24 vjeç, Luan Tepshi 46 vjeç dhe Laert Teneqexhi 25 vjeç. Futbollisti 24-vjeçar nga Durrësi akuzohet nga Itali si anëtar i një organizate kriminale që ka trafikuar 15 kokainë nga Holanda në Itali në periudhën korrik 2013-qershor 2014. Ai ka luajtur me disa skuadra me Teutën, Leshnjën, Kastriotin, Kamzën, Apolloninë dhe për pak kohë me ekipin e Bohemians Praga, në Çeki.

ALUDIMET

A ka kërkuar Gianni De Biasi largimin e Bushit si menaxher?

Trajneri i kombëtares shqiptare Gianni De Biasi sipas 'Gazetaolle' ka pasur një debat të ashpër me menaxherin e Kombëtares Alban Bushi, para konferencës për shtyp të hënën, pasi ka kërkuar që Bushi të mos jetë më menaxher. Gjithçka lidhet me disa deklarata të Bushit ditët e shkuara, që nuk i kanë pëlqyer De Biasit, i cili nuk dëshiron më ta ketë në staf Bushin, ndaj edhe ka pasur një debat me të. Vendimi final do të merret nga presidenti Armand Duka, i cili nuk ishte në federatë të hënën, por ndërkohë Bushi është shfaqur në grumbullimin e kombëtares në Durrës.



Rei Manaj dhe Frederik Veseli

CILËSIA E PERSONAZHEVE NDIKON NË CILËSINË E SPEKTAKLIT

**Vlerat**

Duam të fitojmë statusin e artistit pa qenë të tillë. Pa asnjë background, pa asnjë meritë. Dhe më e keqja, të pa edukuar. E dhimbshme ta mendosh seriozisht që ka ardhur koha kur dikush nga rruga mund të serviret si vlerë



Robert Aliaj: Mjaftojnë mbathjet e bukura dhe ti ke vlerë

Artisti flet për raportin me Valbonën: "Valbona është një mikeshë e vyer. Pa dashje ra në grackën e thurur nga personazhe anonime"

IZAURA NDOJ
TIRANE

Ai është artist dhe si i tillë gjithmonë ka folur drejt-përdrejtë! Ky është Robert Aliaj, artisti i cili di të rrëfej 'live' çdo mendim, vërejtje apo adhurim. Edhe pse shpesh herë është etiketuar si 'delja e zezë' në spektaklin "Dance With

Me" ai ka treguar se di të vlerësoj atë që vërtetë bën art, jep maksimumin dhe nuk është banal përballë një publiku të gjerë. Këtë të hënë ndodhi ndryshe, ai u përfshi sërish në një debat të gjerë, ku fillimisht përplasjen e parë e pati me aktoren Markela Dede dhe të dytin me Viola Spiron. Po në këtë vorbull reagimesh në lojë hyri edhe ish-missi, Valbona Selimllari, e cila është edhe mikeshë më e mirë e Bertit. Lidhur me këtë dyshim të miqësisë së tyre artisti Robert

Aliaj na rrëfen pa cenuar të gjitha lidhjet e forta në këtë spektakël, vlerësimin dhe lojën e pistë të disa personazheve. Pavarësisht debatit që Bona dhe Berti patën 'live', ai i bindur për miqësinë e vjetër thotë se Valbona është mikeshë e vyer, por pa dashje ra në grackën e personazheve anonimë.

Shpesh të kanë etiketuar si 'delja e zezë' në këtë spektakël. Të shqetëson ky fakt?

Nuk më shqetëson aspak ky fakt, varet kush të cilëson si të tillë. Unë kam një mision më fisnik në këtë spektakël, shumë më të rëndësishëm se sa nevoja për të fituar një status me dy pikë më shumë, (qesh) e trishtueshme. Duam të fitojmë statusin e artistit pa qenë të tillë. Pa asnjë background, pa asnjë meritë. Dhe më e keqja, të pa edukuar. E dhimbshme ta mendosh seriozisht që ka ardhur koha kur dikush nga rruga mund të serviret si vlerë.

Kritika dhe të folurit pa 'doreza' shpesh herë ju ka përplasur me konkurrentët...?

Sigurisht, jetojmë në kohën e hipokrizisë, mediokritetit, korrupsionit, shitjes se vetvetes për një hamburger; injorancës, skuthllikut, pabesive, thashethemeve, etj. Jetojmë në një epokë ku gjithçka është e mundur edhe sikur të jesh pa asnjë vlerë. Mjaftojnë mbathjet e bukura.

Veç thashethemeve, keni miq të

vërtetë në këtë edicion?

Patjetër! Ata që kanë ardhur për të bërë show dhe jo për pikë janë të adhurueshëm.

Të bërit art të vërtetë në Shqipëri është shumë e vështirë. Ju si i shikoni 'artistët' tanë?

Fatkeqësisht të tredhur nga frika e presionit politik, nga kërcënimi se po të reagojsh nuk merr më mbështetje nga institucionet, të zhgënjyer nga bordet që funksionojnë në bazë të koncepteve të klientelizmit, të pa motivuar, të abuzuar. Edhe sikur të mos mjaftonin këto, këtu paratë i marrin për vete atë që kanë në dorë administrimin e parave publike. Nuk ka surpriza këtu.

Veç debateve me Violën dhe Markelën, pse një debat 'live' dhe me Valbonën, mikeshën tuaj. Është e vërtetë që u pajtuat deri në fund të emisionit?

Valbona është një mikeshë e mirë, e mishtë, e pastër, e drejtë. Është impulsive për arsye të cilësive që përmenda më sipër. Si gjithë femrat e brezit të saj, ajo është një femër që ka jetuar në një epokë ku abuzimi me femrat shqiptare ishte një normalitet në këtë shoqëri të pa emancipuar. Kjo e ka bërë atë të jetë e ndjeshme.

Pa dashje ajo ra në grackën e thurur mirë nga personazhe anonime që nuk e di se si u katapultuan aty. Cilësia e personazheve sigurisht që do të ndikojë në cilësinë e spektaklit. Valbona është një mikeshë e vyer.



Robert Aliaj dhe Valbona Selimllari

**Valbona**

është një mikeshë e mirë, e mishtë, e pastër, e drejtë. Është impulsive për arsye të cilësive që përmenda më sipër. Si gjithë femrat e brezit të saj, ajo është një femër që ka jetuar në një epokë ku abuzimi me femrat shqiptare ishte një normalitet në këtë shoqëri të pa emancipuar. Kjo e ka bërë atë të jetë e ndjeshme